



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave

“ Master i Shkencave në “Administrim Publik” me profile a. Politika Publike dhe BE, dhe b. Politika Publike dhe Qeverisje ”

Universiteti Privat “Albanian University”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Klodiana Beshku

Prof. Asoc. Dr. Islam Jusufi

Maj/ 2025

Tabela Përmbledhëse për Programin e studimit Master i Shkencave në: “Administrim Publik” me profile a. Politika Publike dhe BE, dhe b. Politika Publike dhe Qeverisje ofruar nga Universiteti Privat “Albanian University”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Privat “Albanian University”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative
3	Emërtimi i programit të studimit:	Masteri Shkencave në: “Administrim Publik” me profile a. Politika Publike dhe BE, dhe b. Politika Publike dhe Qeverisje
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 56, datë 21.01.2009
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	MASR Nr. 4932/1 prot, datë 05.06.2018.
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 399, datë 28.10.2020 për profilin "Politika Publike dhe Qeverisje" Urdhër QSHA Nr. 400, datë 28.10.2020 për profilin "Politika Publike dhe BE"
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 23, datë 12.04.2019
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	V.a 2022-2023: 7 PAE/ 5 PAK V.a 2023-2024: 6 PAE/4 PAK
18	Numri i studentëve:	V.a 2022-2023 profili “Politika Publike dhe BE”: 3 studentë Profili: “Politika Publike dhe Qeverisje”: 16 studentë

		V.a 2023-2024 profili "Politika Publike dhe BE":0 studentë Profili: "Politika Publike dhe Qeverisje": 7 studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Master i Shkencave në “Administrim Publik” me profile a. Politika Publike dhe BE, dhe b. Politika Publike dhe Qeverisje ofruar nga Universiteti Privat “Albanian University” (AU) i përmbahet standardeve të cilësisë dhe zotëron burimet dhe kualifikimet e nevojshme dhe të specializuara akademike që lidhen me fushën e programit.

Programi i ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në “Administrim Publik” me profile a. Politika Publike dhe BE, dhe b. Politika Publike dhe Qeverisje filloi aktivitetin në vitin akademik 2009-2010 kur u licensua për herë të parë me VKM nr. 56, datë 21.01.2009, akredituar për herë të parë në vitin 2019 me vendim të Bordit të Akreditimit . VBA Nr. 23, datë 12.04.2019, akredituar për një periudhë 5 (pesë) vjeçare deri më 2024.

Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, të Universitetit Privat “Albanian University”. Ky program studimi ofrohet në gjuhën shqipe, në 2 vite akademike, me 120 ECTS. Programi i studimit Master i Shkencave në “Administrim Publik” me profile a. Politika Publike dhe BE, dhe b. Politika Publike dhe Qeverisje synon të ofrojë një thellim të koncepteve në fushën e qeverisjes dhe administrimit publik dhe kërkimin shkencor në funksion zhvillimit të rolit të sektorit publik në zhvillimin e vendit dhe lidhjet e tij me fusha të tjera të realitetit shoqëror. Misioni i këtij programi është të përgatisë studentë të cilët të aftësohen në kërkim shkencor, hartimin e politikave publike brenda strukturave që lidhen direkt dhe indirekt me administratën publike qendrore dhe lokale, ekspertë të BE-së dhe doktorantë në Shkenca Politike dhe Administrative.

Albanian University ka përcaktuar drejtimet prioritare akademike në dokumentat e veta strategjike dhe synon ndërtimin e të gjitha kurrikulave në përputhje me kërkesat e ‘Kartës së Bolonjës’ dhe përshtatjen e tyre me ndryshimet social-ekonomike dhe zhvillimet e tregut të punës. Realizimi i këtyre prioritetëve synohet nëpërmjet përmbushjes së misionit të IAL-së të përcaktuar në Statutin e tij.

Përgjatë procesit të vlerësimit të jashtëm, GVJ konstatoi se ky program studimi është ofruar në përputhje me këto prioritete. Ofrimi i programit të studimit Master i Shkencave në “Administrim Publik” me profile a. Politika Publike dhe BE , dhe b. Politika Publike dhe Qeverisje, emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e tij janë në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të IAL-së. Programi është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Arsimin 2021-2026, Strategjinë Kombëtare për Rininë 2022-2029 dhe me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim European 2022-2030.

Ky program realizon synimin e tij për ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare përgjatë të gjithë dokumentacionit të hulumtuar me qëllim akreditimin e tij nga grupi i ngritur për hartimin e RVJ-së. Ky program studimi ofron njohuri teorike dhe aftësi praktike në fushën e BE-së, Qeverisjes dhe Administrimit Publik dhe studenti, i cili zotëron një diplomë të tillë, mund të vazhdojë studimet doktorale, të thellohet në kërkim shkencor ose të punësohet si specialist në administratën e sektorit privat dhe publik. Njohuritë mbi sistemet politike, shkencat e administrimit dhe institucionet e standartet e BE-së si dhe

aftësimi profesional i ekspertëve të ardhshëm të administratës në fuksion të mbarëvajtjes së shtetit e zhvillimit të tij janë nga objektivat kryesorë të këtij programi.

AU ka në disponim mjedise të pajisura me infrastrukturë mësimore që janë të përshtatshme për zbatimin efektiv të programit të studimit. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje me aktorë të ndryshëm, duke përfshirë institucionet publike, bizneset, dhe organizatat e shoqërisë civile. AU ka zbatuar një sistem të brendshëm për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe të menaxhimit të krijuar për të mbështetur administrimin, rrjedhën e informacionit dhe monitorimin e aktiviteteve akademike, financiare dhe administrative në lidhje me programin e studimit. Politikat, proceset dhe aktivitetet për sigurimin e cilësisë përfshijnë të gjithë aktorët përkatës, duke përfshirë strukturat, stafin akademik dhe studentët.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. Raport i vlerësimit të jashtëm përmbledh informacionet të mbledhura nga shqyrtimi i dokumentacionit që Institucioni ka vënë në dispozicion dhe vizitës së realizuar për këtë proces. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesin një situatë sa më reale, për mënyrën se si performon institucioni në ofrimin e këtij programi studimi.

Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- ☐ Standardet nuk përmbushen;
- ☐ Standardet përmbushen pjesërisht;
- ☐ Standardet përmbushen kryesisht;
- ☐ Standardet përmbushen plotësisht.

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat GVJ është njohur që në fillim të angazhimit të tij. GVJ është i përbërë nga ekspertët Asoc. Prof. Dr. Klodiana Beshku dhe Asoc. Prof. Dr. Islam Jusufi. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Msc Alma Arapi, koordinatore teknike e ASCAL.

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar dokumenta dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB). Dokumentacioni i vënë në dispozicion të procesit ka ndihmuar në hartimin e këtij raporti. Ky dokumentacion ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetjeve, të cilat u realizuan gjatë vizitës nëte institucioni në datat 21 dhe 22 tetor 2024 sipas një agjende gjithëpërfshirëse të hartuar nga përfaqësues të ASCAL. Gjatë vizitës dhe vlerësimit u vu re një disponibilitet nga strukturat akademike dhe administrative burokratike nga institucioni për t'i vënë në dispozicion GVJ dokumentacionin e nevojshëm për vlerësimin e programit. Bisedat me stafin administrativ, akademik dhe studentët ofruan informacion të drejtpërdrejtë të përpjekjeve të tyre për përmbushjen e standardeve të cilësisë dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor. Takimi me përfaqësues të NJSBC konfirmoi faktet për proceset e sigurimit të cilësisë në IAL "Albanian University". Kontaktet gjatë vizitës u përmbyllën me shqyrtimin e të dhënave statistikore në sekretariatë mësimore dhe inventarit të fondit të Bibliotekës së IAL "Albanian University". Vizita u mbyll me njohjen e mjediseve, sallave, auditoreve, laboratoreve ku zhvillohej procesi mësimor për këtë program studimi.


Për hartimin e raportit, veç raportit të vlerësimit të brendshëm, dokumentave mbështetëse të përcjella nga IAL në Dosjen e Vetëvlerësimit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u bazua edhe në vizitën dy ditore që realizoi në institucion në data 22 dhe 23 Tetor 2024, si dhe mori në shqyrtim edhe dokumenta të tjera dhe informacione të marra gjatë takimeve dhe intervistave që u kryen gjatë vizitës në institucion, si për shembull me Dekanin e Fakultetit, drejtues të departamentit, personelin akademik dhe studentët, përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm dhe Cilësisë, GVB, sekretarinë, zyrën e karrierës, punonjësen e bibliotekës, përfaqësues nga zyra Burimeve njerëzore etj.

Në bazë të vlerësimit kanë qenë kriteret ligjore në Ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e

Shqipërisë”, Standardet e Cilësisë të aprovuara në Kodin e Cilësisë, si dhe aktet ligjore e nënligjore përkatëse si edhe VKM nr. 41 e vitit 2018 e udhëzimi nr.1 i vitit 2020.

Metodologjia e ndjekur për shkrimin e këtij raporti është analizimi i dokumentave dhe rishikimi i kriterëve e kërkesave ligjore në lidhje me akreditimin e programeve të studimit të nivelit të ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri. Grupi i vlerësimit të jashtëm shqyrtoi rreth 90 evidenca të depozituara nga GVB në portalin e ASCAL si dhe rreth 20 të tjera evidence shtesë të kërkuara gjatë vizitës në institucion prej GVB-së. Gjithashtu, u kryen disa takime online ku u diskutuan disa pika të rëndësishme të ekspertizës e të këtij raporti ku u ra dakort për vlerësimin final në lidhje me pikat e diskutuara.

Puna e GVJ-së është karakterizuar nga kriterë rigoroze profesionalizmi, paanshmërie dhe kredibiliteti të cilat sigurohen nga ekspertiza dhe eksperiencia e anëtarëve të GVJ-së.



SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 23, datë 12.04.2019 janë:

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të akreditimit të mbështetur në vendimin numër 23, datë 12.04.2019 janë si vijon:

1. Institucioni të bëjë përpjekje për të mundësuar kualifikimin e mëtijshëm të stafit akademik si dhe të krijojë infrastrukturën e nevojshme për të planifikuar dhe zhvilluar bashkëpunime me institucione partnere për të qenë pjesë e projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare.
2. Institucioni të shtojë marrëveshjet e bashkëpunimit për këtë program studimi e të përditësojë marrëveshjet aktuale, në kuadër të realizimit të praktikës profesionale/internship mobilitetit të stafit akademik dhe të studentëve si dhe realizimin e aktiviteteve ekstra-kurrikulare.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Për plotësimin e rekomandimeve, insitucioni në fjalë ka marrë këto masa:

1. Bordi i Administrimit të Albanian University vendosi me vendimin nr. 29, nr. 1164 Prot, të alokojë një fond prej 50.000 euro në mbështetje të botimeve në Revista me Scopus dhe faktor impakti nga kërkuesit shkencorë, në dobi të kërkimit shkencor.
2. Institucioni, në kuadër të shtimit të marrëveshjeve ndër-institucionale për shkëmbimin mes stafeve, mobilitetit të studentëve dhe për realizimin e aktiviteteve ekstra-kurrikulare ka nënshkruar dhe përditësuar një sërë marrëveshjesh me organizata, IAL të tjerë, insitucionë kombëtare dhe me disa Insitucione ndërkombëtare në kuadrin e programit Erasmus +.

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft-raportin , sqaron si vijon:

Lidhur me komentet e Albanian University të datës 8 Maj 2025 ndaj draft-raportit të vlerësimit të jashtëm të paraqitur më 28 Prill 2025, dëshirojmë të informojmë si më poshtë:

- **Lidhur me komentin nr. 1** që ka të bëjë me mbështetjen financiare për kërkimin shkencor, dëshirojmë të informojmë se jemi dakord me komentet e dhëna dhe për këtë arsye biem dakord të fshijmë komentet e dhëna me shkronja të trasha në Standardin II.6, Kriteret 4.

- **Për komentin nr. 2** që ka të bëjë me punën e Zyrës së Burimeve Njerëzore, ideja jonë ishte që Albanian University të krijojë një Zyrë të veçantë të Burimeve Njerëzore, e cila do t'i dedikohet vetëm nevojave të Universitetit Shqiptar. Prandaj, ne do të donim të propozonim që në Tekst (faqe 48, Standardi IV.1, Kriteri 6, fjalia e fundit) edhe te Rekomendimet (faqe 96, pika 6 dhe faqe 99, pika 6) që fjalia të formulohet si: "Do të ishte mirë që për këtë qëllim të kishte një Zyrë të veçantë të menaxhimit të burimeve njerëzore i dedikuar në mënyrë specifike vetëm për stafin akademik dhe administrativ në ndihmë të AU".

Me respekt,

Prof. Asoc. Klodiana Beshku (Ph.D)

Prof. Asoc. Dr. Islam Jusufi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:
“Administrim Publik” me profile a. Politika Publike dhe BE, dhe b. Politika Publike
dhe Qeverisje ofruar nga Universiteti Privat “Albanian University”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti Privat “Albanian University”, si institucion i cili ofron Programin Master i Shkencave në “Administrim Publik” me profile a. Politika Publike dhe BE , dhe b. Politika publike dhe qeverisje këtu në shqyrtim, është kujdesur që ky program të jetë në linjë me interesat kombëtarë për diplomimin e studentëve të cilët më pas do të jenë qytetarë dhe ekspertë të përgatitur në politika, administrim publik dhe Bashkimin European, me një ndjenjë të lartë detyre dhe etike profesionale. Programi është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Arsimin 2021-2026, Strategjinë Kombëtare për Rininë 2022-2029 dhe me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim European 2022-2030. Vizioni strategjik i AU (Evidencë 1.1.a dhe 1.1.b) është në linjë me dokumentat dhe vlerat e sipërcituara dhe kjo transmetohet edhe në të gjithë boshtin e vlerave që e përshkron këtë Program Masteri Shkencor (Evidenca 1.7). Programi realizon synimin e tij për ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare përgjatë të gjithë dokumentacionit të hulumtuar me qëllim akreditimin e tij nga grupi i ngritur për hartimin e RVJ-së. <i>(Referencë Evidenca 1.1.a Statuti AU; Evidenca 1.1.b Statuti i miratuar korrik 2023; Evidenca 1.7 Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Adm. Publik me profile 1)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Masteri Shkencor në “Administrim Publik” me profile a. Politika Publike dhe BE , dhe b. Politikat publike dhe qeverisje është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit i cili konsiston në rritjen e cilësisë së arsimit të lartë, lidhja më tregun e punës si dhe përgatitja e ekspertëve të mirëfilltë për Administrimin Publik dhe BE-në, të shprehura këto në Statutin e AU (evidenca 1.1.a.b), në Planin strategjik të Albanian University (evidenca 1.2 a, b) si dhe në Planin Strategjik për Zhvillimin Institucional (evidenca 1.3 a, b) duke synuar adresimin e nevojës për t’iu përgjigjur kërkesave të

	kohës, për të formuar specialistë me kompetenca të gjera nëpërmjet ofrimit të një mësimdhënieje shkencore shumëdisiplinore. Ky program Masteri Shkencor (Evidenca 1.7) është në linjë me misionin e shprehur në Rregulloren e Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative (DSHJPA) (Evidence 1.4) të sipërpërmendura si edhe me Strategjinë e këtij Departamenti (Evidence 1.5) e cila synon rritjen e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet kualifikimit të vazhdueshëm të stafit mësimor si edhe lidhjen e mësimdhënies me kërkimin shkencor. <i>(Evidence 1.4 dhe 1.5). (Referenca: Evidenca 1.1.a Statuti AU; Evidenca 1.1.b Statuti i miratuar korrik 2023 i ri; Evidenca 1.2.a Rregullore e AU e vjeter; Evidenca 1.2.b. Rregullore AU perdituesuar; Evidenca 1.7 Rregullore e Programit te Studimit Master i Shkencave ne Adm. Publik me profile 1; Evidenca 1.2.a Rregullore e AU Evidenca 1.2.b. Rregullore AU perdituesuar; Evidenca 1.3.a Plani Strategjik Institucional 2017-2022; Evidenca 1.3.b Plani Strategjik Institucional 2023-2028; Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit te Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative; Evidenca 1.5 Plani strategjik i Departamentit te Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative).</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	Programi i studimit (evidenca 2.1) është në përputhje me Planin Strategjik për Zhvillimin Institucional (evidenca 1.3 a, b), me planin e masave të marra në kuadër të strategjisë (Evidence 1.6), me Statutin e Institucionit (evidence 1.1 a, b) dhe Rregulloren e Institucionit (1.2 a, b). Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative i cili e implementon këtë program ka hartuar Strategjinë e tij (evidenca 1.5) si edhe planin e masave për realizimin e objektivave strategjike të këtij Institucioni. <i>(evidencë 1.6). (Referencë: Evidenca 2.1. Plani mesimor i programit të studimit Master i Shkencave; Evidenca 1.2.a Rregullore e AU e vjeter; Evidenca 1.2.b. Rregullore AU perdituesuar; Evidenca 1.3.a Plani Strategjik Institucional 2017-2022; Evidenca 1.3.b Plani Strategjik Institucional 2023-2028; Evidenca 1.5 Plani strategjik i Departamentit te Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative; Evidenca 1.6 Plani i masave i marrë në kuadër të strategjisë).</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje	Programi i studimit Masteri Shkencor (evidencë 2.1) është hartuar në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prireje globale të zhvillimit, me qëllimin për të qenë

me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	një Master konkurrues në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Për këtë qëllim, sugjerohet që të theksohet komponenti i Bashkimit European dhe Integritimit European në Rregulloren e këtij programi (Evidenca 1.7) pasi theksi është vendosur vetëm mbi qeverisjen dhe adiminsitrimin publik su fusha konkurruese dhe formuese ku bazohet ky program. Ky program është mbështetur në Strategjinë Institucionale (evidencë 1.3 a, b), në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030 dhe në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026. <i>(Referencë: Evidenca 2.1. Plani mesimor i Programit të studimit Master Shkencor; Evidenca 1.3.a Plani Strategjik Institucional 2017-2022; Evidenca 1.3.b Plani Strategjik Institucional 2023-2028; Evidenca 1.7 Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Adm. Publik me profile 1).</i>			
Konkluzione	Programi i studimit Master i Shkencave në “Administrim Publik” me profile a. Politika Publike dhe BE, dhe b. Politika publike dhe qeverisje, është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, të shprehura këto në Statutin e AU, Planin strategjik të Albanian University, Planin Strategjik për Zhvillimin Institucional, Rregulloren e Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative si edhe me Strategjinë e këtij Departamenti. Programi është hartuar në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030 dhe në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026. Sugjerohet që të theksohet komponenti i Bashkimit European dhe Integritimit European në Rregulloren e këtij programi pasi theksi është vendosur kryesisht mbi qeverisjen dhe adminstrimin publik si fusha konkurruese dhe formuese ku bazohet ky Program.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e	Universiteti Privat “Albanian University”, Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative ka kapacitetin, burimet dhe


duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	përvojën e duhur për ofrimin e Masterit Shkencor në “Administrim Publik” me profile a. Politika Publike dhe BE, dhe b. Politika publike dhe qeverisje në burime njerëzore, operative dhe në kapacitete infrastrukturore. Programi në fjalë ofrohet nga Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, i cili ka një përvojë të gjerë e të hershme në shkencat administrative pasi edhe cikli Bachelor është i specializuar në këtë drejtim, ndërsa vetë institucioni (AU) dhe stafi mësimdhënës i tij ka një përvojë të gjatë në shkenca juridike, administrative dhe në çështje të Studimeve Evropiane.
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Administrim Publik” me profile a. Politika Publike dhe BE, dhe b. Politika publike dhe qeverisje, ofrohet nga Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative dhe Fakulteti i Shkencave Shoqërore. Ky Fakultet përfshin fushën specifike studimore-shkencore që është: Shkenca juridike dhe politiko-administrative e cila përkon me Departamentin e Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative si njësia bazë ku mbështetet ky Program. Fusha e përgjithshme dhe specifike e këtij programi është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore përgjegjëse për programin e studimit dhe është në linjë me direktivat dhe udhëzimeve kombëtare dhe evropiane.
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	NA
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	NA

Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Albanian University ofrón praktika profesionale për studentët e diplomuar dhe përpiqet ti lidhë këta studentë më shumë me tregun e punës nëpërmjet panairëve, seminareve, ditëve të hapura me stuktura të ndryshme akademike dhe publike (Ref: Evidenca 1.8 Aktivitete Ekstrakurrikulare). Ofrimi i trajnimeve profesionale për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit mbetet një sfidë e mëtejshme për të gjithë sistemin universitar shqiptar.			
Konkluzione	Albanian University, Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative ka kapacitetin, burimet dhe përvojën e duhur për ofrimin e programit Master i Shkencave në "Administrim Publik" me profile a. Politika Publike dhe BE, dhe b. Politika publike dhe qeverisje si në burime njerëzore ashtu edhe në kapacitete infrastrukturore e në ofrimin e një mësimdhënieje cilësore për studentët e këtij programi prej një stafi të kualifikuar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Ndarja e detyrave mes rektorit/dekanit/përgjegjësit të departamentit dhe mes përgjegjësit të departamentit/titullarëve të lëndëve është shumë e qartë dhe efikase dhe kjo ndikon në krijimin e një atmosfere jo vetëm profesionale, por edhe të qetë në AU. Koordinatori i caktuar në vitin 2021 është ende staf i këtij programi (Evidenca 2.3) dhe një figurë e përkushtuar dhe kyçe për këtë program studimi (Ref. Vizita nga GVJ në institucion). Analiza e punës në nivel njësie bazë realizohet në mënyrë periodike, siç na u kofirmua edhe përgjatë vizitës në insitucion, por siç edhe është e dukshme nga Raportet një vjeçare dhe 6 mujore. (evidence 1.9 dhe 1.10). (Referenca: Evidenca 2.3. Shkresa per caktimin e koordinatorsit te programit te studimit; Evidenca 1.9 Raport Vjetor i Departamentit te Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative; Evidenca 1.10 Raport Semestral i Departamentit te Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative).



Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Universiteti Privat “Albanian University” zotëron marrëveshje të ndryshme me Institucione brenda dhe jashtë vendit të listuara në Planin Strategjik të DShJPA si Kuvendi i Shqipërisë, Akademia e Shkencave, Drejtoria e Arkivave (Evidenca 1.5, faqe 11,12); me IAL brenda vendit dhe rajon si Universiteti “Fan.S.Noli”, Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, UAMD, ISPE-Kolegji Prishtinë, Universiteti i Strugës (Evidencë 1.10 pika 7) si edhe me IAL ndërkombëtare në kuadrin e marrëveshjeve dypalëshe si Univeristeti i Salernos dhe i Cusanos në Itali dhe Kirchliche Pedagogische Hochschule Krams/Wien Austri. <i>(Evidenca R.2). (Ref: Evidenca 1.5 Plani strategjik i Departamentit te Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative; Evidenca 1.9 Raport Vjetor i Departamentit te Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative; Evidenca 1.10 Raport Semestral i Departamentit te Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative; Evidenca R.2 Marrëveshje të Departamentit në funksion të programit të studimit).</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj,dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademikt dhe studentëve.	Albanian University disponon marrëveshje me IAL të tjera brenda dhe jashtë vendit, me Institute e Qendra të Kërkimit shkencor (Evidenca R.2) si edhe me Institucione publike si Kuvendi, Bashkia Tiranë, Autoriteti i Dosjeve dhe Instituti i Sigurimeve. Departamenti duhet të përcaktojë një udhëheqës për praktikant mësimor (koordinant të praktikave mësimore) i cili koordinon punën mes insitucioneve që ofrojnë praktikant dhe këtij program masteri. Sugjerohet një koordinator i përhershëm për praktikant për këtë program. <i>(Referencë: Evidenca 1.5 Plani strategjik i Departamentit te Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative; Evidenca 1.9 Raport Vjetor i Departamentit te Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative; R.2 Marrëveshje të Departamentit në funksion të programit të studimit.pdf</i> <i>Evidenca 1.10 Raport Semestral i Departamentit te Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative; E.2. Praktika e ndjekjes së studentëve gjatë praktikës).</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike	Departamenti harton një raport analitik vjetor (evidenca 1.9) në të cilin janë të listuar institucionet me të cilët IAL/ja ka marrëveshje dhe një raport semestral ku flitet për ecurinë e praktikave profesionale (evidencë 1.10)

të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	(Ref. Evidenca 1.9 Raport Vjetor i Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politikko-Administrative; Evidenca 1.10 Raport Semestral i Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politikko-Administrative).			
Konkluzione	Departamenti ka hartuar një raport analitik vjetor në të cilin janë të listuar institucionet me të cilët IAL/ja ka marrëveshje dhe një raport semestral ku flitet për ecurinë e praktikave profesionale me IAL kombëtare, ndërkombëtare, Institucione të Kërkimit shkencor dhe Institucione të Adminsitratës qendrore e lokale. Sugjerohet një koordinator i përhershëm për praktikat për këtë program.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Master i Shkencave në “Administrim Publik” me profile a. Politika Publike dhe BE, dhe b. Politika publike dhe qeverisje (evidencë 2.1) i ofron studentëve një thellim të mëtijshëm në qeverisje, shkenca të administrimit publik dhe studime europiane. Në bazë të këtij programi, studentët përftojnë dijet e nevojshme për të vazhduar rrugëtimin në kërkimin shkencor ose për tu përfshirë në tregun e punës si ekspertë të administratës publike ose private. Ky program është i organizuar në 120 kredite dhe module sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sipas këtij sistemi dhe sipas VKM-së 41 të vitit 2018, ky program duhet të ketë një ndarje të tillë të sistemit të krediteve: Master i shkencave:




	Lëndë bazë (A): 5%-10% Lëndë karakterizuese (B): 50%-60% Lëndë ndërdisiplinore/integruese (C): 12%-20% Lëndë plotësuese (D): 10% Detyrime përmbyllëse (E): 10%-15% Duke u nisur nga kjo ndarje, konstatojmë se Programi i Studimit Master i Shkencave në "Administrim Publik" me profile a. Politika Publike dhe BE, dhe b. Politika publike dhe qeverisje (evidencë 2.1) dhe ndarja sipas kategorive të lëndëve sipas Rregullores së Programit (evidenca 1.7, faqja 6-7) i përmbush këto detyrime në përputhje me VKM-në 41 e vitit 2018 sipas kësaj ndarjeje: Lëndë bazë (A): 5.8% Lëndë karakterizuese (B): 53% Lëndë ndërdisiplinore/integruese (C): 15.8% Lëndë plotësuese (D): 10% Detyrime përmbyllëse (E): 15% Pra, sipas kësaj ndarjeje, kuadri i përgjithshëm formues i këtij programi Master shkencor është në përputhje me VKM-në e sipërcituar (Ref: Evidenca 2.1. Plani mesimor i programit të studimit Master i Shkencave; Evidenca 1.7 Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Adm. Publik me profile 1)
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të	Ky program studimi synon formimin e kompetencave të veçanta për studentët në fusha si: Shkenca politike, administrim publik, politika publike, Bashkimi Europian për një qeverisje të përmirësuar, transparente e të hapur. Pas programit bazë Bachelor në Shkenca Politike, ky program Masteri Shkencor jep njohuri të thelluara në këto fusha si më sipër, duke lehtësuar kalimin në fushën akademike të doktoratës, në kërkimin shkencor ose në punësimin në ambiente të lidhura me këto fusha si administrata publike dhe politikëbërja. Ky program zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në qeverisje, shkenca politike, administrim publik dhe studime evropiane, të nevojshme për vijueshmërinë në fushën e kërkimit shkencor ose në tregun e punës apo në zbatimin e politikave publike dhe vendimmarrjes politike.

specializuar studimi ose profesionale.	
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Në kurrikulën/planin mësimor të Masterit Shkencor në Administrim Publik me profile a. Politika Publike dhe BE, dhe b. Politika publike dhe qeverisje është përcaktuar qartë ngarkesa në kredite e praktikës profesionale (6 kredite) dhe detyrimeve përmbyllëse (18 kredite), secila llogaritur në përqindje shkon në kuotën 15%. (Ref. Evidenca 2.1. Plani mesimor i programit të studimit Master i Shkencave). Kjo përqindje është në linjë me VKM-në 41/2018.
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	NA
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	NA

Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Universiteti Privat "Albanian University" nuk është institucion i arsimit të lartë me status të veçantë.
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Nuk ka një program tjetër Master në të njëjtën fushë studimi. Me programin e studimit të ciklit të dytë Master profesional në "Qeverisje dhe Administrim Publik" që disponon AU ka një përmbajtje të ngjashme në nivel me së paku 70 për qind.
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	AU është angazhuar që ky programi Master Shkencor në "Administrim Publik" me profile a. Politika Publike dhe BE, dhe b. Politika publike dhe qeverisje të shoqërohet me kodin përkatës sipas udhëzimit të MASR nr 31, dt. 15.11.2022
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi në fjalë nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera
Konkluzione	Programi Master Shkencor në Administrim Publik me profile a. Politika Publike dhe BE, dhe b. Politika publike dhe qeverisje është i organizuar saktësisht në kredite dhe module sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe sipas VKM-së 41 të vitit 2018.

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																		
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Njësia bazë, Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative, përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin, në përputhje me aktet rregullatore të Institucionit, të bazuara në strategjitë kombëtare e institucionale dhe në përditësim të vazhdueshëm të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Struktura dhe stafi akademik i programit janë brenda kriterëve të përcaktuara nga Ligji për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor i vitit 2015, Udhëzimi nr.1 i datës 14.01.2020 dhe VKM-ja e datës 24.01.2018, siç verifikohet lehtësisht nga evidenca 2.1 e programit mësimor dhe evidence 4.1 e ngarkesës mësimore të stafit akademik. <i>(Ref: Evidenca 1.9 Raport Vjetor i Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative; Evidenca 4.1 Ngarkesa mesimore e stafit).</i> <table><tr><th rowspan="2">Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td>1</td><td>1</td><td>1</td><td>1</td></tr><tr><td>Prof.As.Dr</td><td>3</td><td>4</td><td>2</td><td>6</td></tr><tr><td>Dr</td><td>7</td><td>12</td><td>7</td><td>7</td></tr><tr><td>MSc</td><td>3</td><td>7</td><td>3</td><td>4</td></tr><tr><td>Total</td><td>14</td><td>24</td><td>13</td><td>18</td></tr></table>	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative	2022-2023		2023-2024		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	1	1	1	1	Prof.As.Dr	3	4	2	6	Dr	7	12	7	7	MSc	3	7	3	4	Total	14	24	13	18
Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative	2022-2023		2023-2024																																
	PAE	PAK	PAE	PAK																															
Prof.Dr	1	1	1	1																															
Prof.As.Dr	3	4	2	6																															
Dr	7	12	7	7																															
MSc	3	7	3	4																															
Total	14	24	13	18																															




Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																		
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Njësia bazë, Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative, përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin, në përputhje me aktet rregullatore të Institucionit, të bazuara në strategjitë kombëtare e institucionale dhe në përditësim të vazhdueshëm të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Struktura dhe stafi akademik i programit janë brenda kriterëve të përcaktuara nga Ligji për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor i vitit 2015, Udhëzimi nr.1 i datës 14.01.2020 dhe VKM-ja e datës 24.01.2018, siç verifikohet lehtësisht nga evidenca 2.1 e programit mësimor dhe evidence 4.1 e ngarkesës mësimore të stafit akademik. <i>(Ref: Evidenca 1.9 Raport Vjetor i Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative; Evidenca 4.1 Ngarkesa mesimore e stafit).</i> <table><tr><th rowspan="2">Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td>1</td><td>1</td><td>1</td><td>1</td></tr><tr><td>Prof.As.Dr</td><td>3</td><td>4</td><td>2</td><td>6</td></tr><tr><td>Dr</td><td>7</td><td>12</td><td>7</td><td>7</td></tr><tr><td>MSc</td><td>3</td><td>7</td><td>3</td><td>4</td></tr><tr><td>Total</td><td>14</td><td>24</td><td>13</td><td>18</td></tr></table>	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative	2022-2023		2023-2024		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	1	1	1	1	Prof.As.Dr	3	4	2	6	Dr	7	12	7	7	MSc	3	7	3	4	Total	14	24	13	18
Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative	2022-2023		2023-2024																																
	PAE	PAK	PAE	PAK																															
Prof.Dr	1	1	1	1																															
Prof.As.Dr	3	4	2	6																															
Dr	7	12	7	7																															
MSc	3	7	3	4																															
Total	14	24	13	18																															




Fakulteti i Shkencave Shoqërore	2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	2	2	2	2
Prof.As.Dr	6	12	8	14
Dr	18	29	16	14
MSc	6	17	7	10
Total	32	60	33	40

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës	Në kuadër të marrëveshjeve që ka institucioni me institucionet e tjera (Raporti vjetor 2022-2023, evidence 1.9), institucioni pritës ka detyrim të përcaktojë një koordinator për praktikantët i cili mban kontaktet me Departamentin dhe raporton për aktivitetin e studentëve praktikantë. Njësia bazë ka të angazhuar sipas rastit një pedagog përgjegjës për praktikantët mësimorë e cila merr në mbikëqyrje grupin e studentëve (jo më shumë se 20 studentë, Evidenca 4.1). Gjatë vizitës në institucion grupit të RVJ-së iu bë me dije mënyra e organizimit të praktikave, roli i institucioneve dhe i koordinators të praktikave si urë lidhëse mes studentëve dhe institucionit, raporti i vlerësimit si edhe mënyra e konvertimit të këtij raporti në notë nga koordinatori/ja e praktikave
--	---

akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	(Ref: Evidenca 2.1. Plani mesimor i programit Master i Shkencave; Evidenca 1.9 Raport Vjetor i Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative; Evidenca 4.1 Ngarkesa mesimore e stafit).			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Sipas evidencës 2.3, ky program ka të përcaktuar një Koordinator i cili merret me ecurinë e programit dhe mbarëvajtjen e mësimdhënies në funksion të studentëve të këtij programi. Koordinatori u takua me grupin e RVJ-së edhe përgjatë vizitës në Institucion me të cilin u diskutua mbi përshkrimin e punës së tij dhe u shkëmbyen mendime mbi praktikat më të mira. (Ref: Vizita në Institucion dhe Evidenca 2.3. Shkresa për caktimin e koordinatorit të programit të studimit)			
Konkluzione	Njësia bazë, Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative, përmbush shumë mire detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike, vlerësimin dhe akreditimin si dhe në lidhje me zhvillimin e praktikës mësimore në përputhje me aktet rregullatore të Institucionit, të bazuara në strategjitë kombëtare e institucionale dhe në përditësim të vazhdueshëm të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ky program ka të përcaktuar një Koordinator i cili merret me ecurinë e programit dhe mbarëvajtjen e mësimdhënies dhe të praktikave të punës në funksion të studentëve të këtij programi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, informacioni cili ndodhet i depozituar në platformën e-ASCAL si edhe online në web https://albanianuniversity.edu.al/en/home/ Ky informacion na u vu edhe në dispozicion përgjatë vizitës në institucion.
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit të PAE dhe të PAK (evidenca 4.1) si edhe çështje të etikës që kanë të bëjnë me angazhimin e studentëve. Ngarkesa mësimore, përfshirë orët në auditor/jashtë auditorit janë konform rregulloreve dhe direktivave në fuqi.	Plani mësimor i këtij programi dhe syllabuset e tij (evidenca 2.1 dhe 2.2) përmbajnë informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit të PAE dhe të PAK (evidenca 4.1) si edhe çështje të etikës që kanë të bëjnë me angazhimin e studentëve. Ngarkesa mësimore, përfshirë orët në auditor/jashtë auditorit janë konform rregulloreve dhe direktivave në fuqi. (Ref: Evidenca 2.1. Plani mesimor i programit te studimit Master i Shkencave; Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve; Evidenca 4.1 Ngarkesa mesimore e stafit).
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	“Rregullorja e Regjistrimeve dhe Transferimeve” e Albanian University (Evidenca 2.4) përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Ky proces është lehtësisht i realizueshëm nëpërmjet një kërkesë të thjeshtë pranë sekretarisë mësimore, i kushtëzuar vetëm prej respektimit të kohërave të pritjes të parashikuara nga kjo rregullore (Ref: Evidenca 2.4. Rregullore e Regjistrimit dhe Trasferimeve).
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikë, seminar apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët	Plani mësimor i këtij programi dhe syllabuset e tij (evidenca 2.1 dhe 2.2) përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikë, seminar apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. Megjithatë procedura e rishikimit të syllabus-eve e parashikon qartë mënyrën se si mund të rishikohen ato (evidenca 2.5), vihet re një mungesë përditësimi të programeve të lëndëve

formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	(syllabuseve) me literaturën e këtyre viteve të fundit, sidomos në lëndë që kanë të bëjnë me juridikionin e të Drejtës si e Drejta e punës apo e Drejta komunitare (e BE-së) e cila është një fushë në ndryshim të vazhdueshëm si edhe me lëndë që kanë të bëjnë më gjerësisht me BE-në, funksionimin e saj dhe politikat europiane. Në këto lëndë ka libra bazë që prej vitit 1997, 1998 dhe gjithsesi jo më tej se viti i botimit 2010 (Ref: Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve; Evidenca 2.5. Procedura e rishikimit të syllabuseve).			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Në fillim të vitit akademik përgjegjësi i Departamentit duhet të angazhohet në verifikimin e përditësimit të syllabuseve të këtij programi sipas Procedurës së Rishikimit të Syllabus-eve (evidencë 2.5) dhe në ndryshimin e 20% të kurrikulës, sipas legjislacionit në fuqi sipas Procedurës së rishikimit të Kurrikulave (evidencë 2.6). Vihet re se nuk ka pasur rishikim të programit në këto vite pas akreditimit të fundit të programit në fjalë në vitin 2019. Gjithashtu, rishikimi i disa syllabus-eve të disa prej lëndëve duket se nuk është kryer sipas periodicitetit që sygjeron kjo procedurë. (Ref:Evidenca 2.5. Procedura e rishikimit të syllabuseve; Evidenca 2.6. Procedura e rishikimit të kurrikulave).			
Konkluzione	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative ofron të gjithë instrumentet e nevojshëm për organizimin, strukturën, përmbajtjen dhe transferimet në lidhje me programin e studimit. Vihet re një mungesë përditësimi të programeve të lëndëve (syllabuseve) të disa prej lëndëve të këtij program me literaturën e viteve të fundit në fushat përkatëse të së Drejtës dhe Studimeve Europiane.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve	Programi i studimit Master i Shkencave në "Administrim Publik" me profile a. Politika Publike dhe BE dhe b. Politika publike dhe qeverisje është i konceptuar në një linjë thellimi të njohurive shkencore të përfuara përgjatë një sistemi bachelor në shkenca

dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	politike dhe të ngjashme (shkenca të administrimit) dhe përvijimin e rrugëtimit në kërkim shkencor dhe doktoratë, osë daljen në tregun e punës si ekspert i mirëfilltë i shkencave politike, shkencave të administrimit dhe studimeve europiane.
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.	Lëndët dhe modulet e këtij program studimi në Master të Shkencave janë të shpërndara në semestra për të mundësuar arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme në profesionalizimin e studentëve të këtij masteri në mënyrë graduale brenda 2 vitesh si edhe përgatitjen e tyre për një thellim në kërkimin shkencor me synim Masterin ekzekutiv ose Doktoratën.
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Struktura e programit është në përputhje me profilin e një programi të studimit të një Masteri Shkencor dhe i përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në këtë kuadër, bazuar në Tabelën 13 (Evidenca nr. 5 Tabelat permbledhese ankes RVB)), veprimtaritë formuese në këtë program ndahen si më poshtë: <i>Leksione 450 orë</i> <i>Seminare 240 orë</i> <i>Detyra kursi, projekte 50 orë</i> <i>Forma të kontrollit të vazhdueshëm 4 orë</i> <i>Praktikë profesionale 414 orë</i> <i>Përgatitje për provimin e Fromimit/Temën e diplomës 36 orë</i> <i>Gjithsej 1190 orë</i> Sipas kësaj ndarjeje, studentit i mundësohet realizimi i objektivave të vendosur nga Programi Master i Shkencave në "Administrim Publik" me profile a. Politika Publike dhe BE, dhe b. Politika publike dhe qeverisje si edhe transferimi i studimeve dhe vazhdimësia në Doktoratë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Programi (MShAP) gjendet edhe në linkun e web-it të AU: https://albanianuniversity.edu.al/sq/fakulteti-i-shkencave-shoqerore-2/

Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe të të nxëniet të dijes në kuadër të këtij programi. Kjo ndarje lehtëson transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin në përfundim të studimeve, në linjë me rregulloret dhe legjislacionin përkatës.
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative duhet të angazhohet në përshtatjen dhe transformimin e këtij programi në përputhje me kërkesat e tregut dhe të transformimeve të shoqërisë prej teknologjisë si edhe në përditësimin e vazhdueshëm të syllabuseve të lëndëve në këtë kuadër. Mundësitë që fasilitojnë këtë proces janë të shumta në AU duke filluar me përditësimin periodik të literaturës në bibliotekën e “Albanian University” sipas Rregullores së Bibliotekës nëpërmjet porosisë së herëpashershme të librave vërtetuar gjatë vizitës në së RVJ-së në IAL si edhe nëpërmjet mundësisë për të shkarkuar materiale online nëpërmjet EBCSO-s <i>(Ref: Vizita në IAL; Evidenca 2.5. Procedura e rishikimit të syllabuseve; Evidenca 2.7. Procedura e pasurimit të bibliotekës.pdf).</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi në fjalë Master i Shkencave synon të formojë ekspertë të përgatitur për të punuar në administratë, shoqëri civile dhe insitucione politikëbërëse e politikëhartuese si edhe studiues shkencorë që do të përballen me sfidën e kërkimit shkencor dhe akademizmit. Përmbajtja e këtij programi e garanton këtë formim të dyfishtë.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Formimi praktik në kuadrin e këtij programi dhe ndjekja e shoqërimit i studentit përgjatë këtij procesi (Ref: Evidenca 1.7 Rregullorja e Programit të Studimit Master Shkencor) bën të mundur integrimin më të shpejtë të të diplomuarve në tregun e punës. Punësimi i studentëve lehtësohet edhe nëpërmjet aktiviteteve ekstrakurrikulare (evidenca 1.8) ku panairët, simpoziumet apo tryezat e rrumbullakëta kanë paur si qëllim afrimin e studentëve me përfaqësues të insitucioneve publike e private dhe ekspertë të fushës. Një shembull i mirë në këtë drejtim është edhe Panairi <i>Work and Study</i>

	(Ref: Evidenca 1.7 Rregullore e Programit te Studimit Master Shkencor; Evidenca 1.8 Aktivitete Ekstrakurrikulare; Evidenca 5.4 Panairi Work & Study).			
Konkluzione	Lëndët dhe modulet e këtij programi janë të shpërndarë në semestra për të mundësuar arritjen e objektivave formues të programit dhe thellimin në dije si edhe profesionalizimin e studentëve të këtij masteri në mënyrë graduale brenda dy vitesh. Formimi teorik dhe ai praktik në kuadrin e këtij programi si dhe mbështetja, ndjekja e shoqërimi i studentit përgjatë këtij procesi bën të mundur integrimin më të shpejtë të të diplomuarve në kërkimin shkencor dhe në tregun e punës. Nuk ka pasur një përditësim të vazhdueshëm të syllabuseve të lëndëve në përputhje me kërkesat e tregut dhe të transformimeve të shoqërisë prej teknologjisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative ka kryer në mënyrë periodike studimin e tregut (Evidenca 2.8) me qëllim adaptimin e këtij programi me tendencat më të fundit të kërkimit shkencor dhe kërkesat e tregut në funksion të përmirësimit e përmbajtjes së këtij programi studimi duke u përpjekur të marrë parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve dhe të aktorëve të tjerë (Ref: Evidenca 2.8. Analize e tregut te punes). Programi nuk rezulton të jetë i rishikuar dhe i përditësuar me inovacionet e fundit në shkencat politike dhe administrative, në funksion të zhvillimit të teknologjisë dhe të transformimit të tregut të punës.
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe	Universiteti Privat "Albanian University" është një institucion i ndjeshëm dhe shumë i kujdesshëm ndaj kërkesave të studentëve dhe mbarëvajtjes së tyre në tregun e punës edhe pas përfundimit të këtij programi. Nëpërmjet koordinatorit për studentët dhe takimeve periodike me ta në kuadrin e Këshillit Studentor dhe Senatit




konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Akademik është krijuar rrjeti i studentëve alumni (evidenca 2.9) duke i angazhuar ata edhe në aktivitete që organizohen prej studentëve për studentët (evidencia 2.11). Programi i përshtatet studentëve përsa i përket fleksibilitetit në orare dhe kërkesa të tjera specifike që ata mund të kenë. Kjo na u konfirmua edhe përgjatë vizitës në institucion ku studentët u shprehën se ndjekja e programit ishte lehtësuar prej këtij fleksibiliteti të zbatuar nga AU <i>(Referencë: Vizita në IAL; Evidenca 2.9. Model pyetësori ALUMNI; Evidenca 2.11. Lista e aktiviteteve studentore (leksione te hapura, workshope, tryeza te rrumbullakta)</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative mban kontakte me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra dhe institucione publike e private. Në grupin e ekspertëve janë të angazhuar edhe ekspertë të jashtëm për përmirësimin e kurrikulave (evidenca 2.10) të cilët janë angazhuar në këtë proces. Ndryshimi i programit (kurrikulës) në këto dy vitet e fundit ka qenë në kuotën nën 20% <i>(Ref: Evidenca 2.10. Shkresa per ngritjen e komisionit per rishikimin te programit studimit; Evidenca 2.6. Procedura e rishikimit te kurrikulave).</i>			
Konkluzione	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative mban kontakte me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra dhe institucione publike e private, por nuk i reflekton sugjerimet e tyre. Programi i përshtatet studentëve përsa i përket fleksibilitetit në orare dhe kërkesa të tjera specifike që ata mund të kenë. Rishikimi i kurrikulës së këtij programi herë pas here, i refletkon këto nevoja.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të	Prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit janë shprehur qartë në Rregulloren e këtij Programi studimi (evidenca 1.7, kreu II, neni 4). Ato specifike mund të përmbledhen në katër shtylla kryesore (Ref:

studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Evidenca 1.7 Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Adm. Publik me profile 1): 1. Pajisja e të diplomuarve me aftësi teorike dhe praktike ekzekutive; 2. Zhvillimi i aftësive për konstruksione logjike me bazë teorike dhe empirike; 3. Aftësimi i të diplomuarve për vazhdimësi në kërkimin shkencor; 4. Të diplomuarit të jenë ekspertë të aftë në fushat ku lëvron ky program Masteri Shkencor.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative respekton lirinë akademike të personelit akademik (evidencë 1.4, neni 15). Kjo u evidentua edhe përgjatë vizitës së grupit për hartimin e RVJ-së në Albanian University ku pedagogët u shprehën të qetë dhe të lirë në punën e tyre (Ref: Vizita në Institucion, Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative). Ata mbështeten vazhdimisht në veprimtarinë e tyre të përditshme por edhe atë shkencore dhe akademike nëpërmjet një fondi të posaçëm (Evidencë R.1.b) të vënë në dispozicion nga Albanian University <i>(Ref: Evidencë R.1.b Fondi në mbështetje të botimeve në revista me Scopus dhe faktor impakti nga kërkuesit shkencorë).</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Nësia bazë e këtij programi nxit dhe motivon studentët të angazhohen në Konferencën Studentore si edhe të botojnë në Revistën Optime (kopje të kësaj reviste na u vu në dispozicion përgjatë vizitës në Institucion). Një sërë aktiviteteve si workshop-e, leksione të hapura, trajnime janë konceptuar dhe vënë në zbatim për studentët e AU dhe të këtij programi (evidencë 2.11). I kushtohet vëmendje mobilitetit të studentëve (evidencë 2.12) si dhe aktiviteteve ekstra-kurrikulare ku studentët aktivizohen në vetë të parë (Evidenca 1.8) dhe ndërveprojnë me ekspertë të fushave dhe përfaqësues të trgut të punës (Evidenca 1.8) <i>(Ref: Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative; Evidenca 1.8 Aktivitete Ekstrakurrikulare; Evidenca 2.11. Lista e aktiviteteve studentore (leksione të hapura, workshope, tryeza të rrumbullakta; Evidenca 2.12. Aplikimi në projekte Erasmus + etj 3; Evidenca 2.12. Aplikimi në projekte Erasmus +, Virtu EU etj 2; Evidenca 2.13. Mobiliteti i studenteve; Evidenca R.1.b Fondi në mbështetje të botimeve në revista me Scopus dhe faktor impakti nga kërkuesit shkencorë).</i>

Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Për realizimin e aktiviteteve kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni, pra Albanian University. Pedagogët mbështeten në aktivitetin e tyre prej një Fondi të posaçëm për botimet dhe kërkimin shkencor (Ref: Evidence R.1.b Fondi në mbështetje të botimeve në revista me Scopus dhe faktor impakti nga kërkuesit shkencorë).			
Konkluzione	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative respekton lirinë akademike të personelit akademik. Ai mbështetet vazhdimisht në veprimtarinë e tyre të përditshme por edhe atë shkencore dhe akademike nëpërmjet një fondi të posaçëm të vënë në dispozicion nga Albanian University.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative siguron bashkëpunimin me IAL të tjera dhe Institute apo Qendra Kërkimore Shkencore (evidence 4.1) për realizimin e objektivave të të gjithë programeve të studimit në kërkim shkencor, por duke qenë se ky program nuk e ka kërkimin shkencor qëllimin parësor të tij, më shumë rëndësi i jepet aspekteve më praktike të programit.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative ka aplikuar në shumë projekte me qëllimin për të zhvilluar projekte të karakterit kërkimor shkencor (evidencat 2.12) dhe në kuadër të programit Erasmus+ janë kryer shkëmbime të stafit dhe të studentëve me institucione ndërkombëtare (evidence 2.13) si me Universitet Medyczny Wrocław dhe Afyon Kocatepe University Türkiye. Përpjekjet janë të dukshme dhe

realizimin e këtyre objektivave.	efikase, por megjithatë ato duhet të shtohen në të ardhmen, sidomos në fushën e Shkencave Sociale. (Ref: Evidenca 2.12. Aplikimi ne projekte Erasmus +, vIRTU eu etj 2; Evidenca 2.12. Aplikimi ne projekte Erasmus +, VirtU EU etj; Evidenca 2.12. Aplikimi ne projekte Erasmus, Virt EU + etj 3; Evidenca 2.13. Mobiliteti i studenteve; Evidenca 4.1 Ngarkesa mesimore e stafit akademik).
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative ka zhvilluar Konferenca studentore si edhe leksione të hapura e seminare në funksion të tyre (Evidenca 2.11). Këto aktivitete kanë ndihmuar jo vetëm studentët, por edhe personelin që të shprehet në fushën përkatëse të interesit dhe të dijes që disponon Ref: Evidenca 1.8 Aktivitete Ekstrakurrikulare; Evidenca 2.11. Lista e aktiviteteve studentore (leksione te hapura, ëorkshope, tryeza te rrumbullakta).
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Ky program karakterizohet nga një kurrikul e pasur, shërbime ndaj studentëve, përkushtim ndaj tyre si dhe vendosja e studentëve në kontakt me aktivitete ekstra-kurrikulare (Evidenca 2.11 dhe Evidenca 1.8). Përpjekja për ti përgatitur këta studentë, ndikojnë në formimin e profesionistëve konkurrues për tregun e kombëtar e ndërkombëtar të punës (Ref: Evidenca 2.11. Lista e aktiviteteve studentore (leksione te hapura, workshope, tryeza te rrumbullakta; Evidenca 1.8 Aktivitete Ekstrakurrikulare).
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	NA
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përpunet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva	NA

dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU).				
Konkluzione	Ky program konsiderohet i suksesshëm përse i përket formimit të profesionistëve për tregun e kombëtar e ndërkombëtar nëpërmjet kurrikulës së tij, shërbimeve ndaj studentëve, përkushtimin ndaj tyre si edhe me angazhimin e studentëve në aktivitete ekstra-kurrikulare në dobi të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Transmetimi i dijeve, format e mësimdhënies e mësimnxënies janë të parashikuara në syllabus-et e lëndëve (evidencë 2.2) si edhe në Rregulloren mësimore të Programit të studimit (evidence 1.7). Personeli akademik ushtron si format e mësimdhënies klasike, ashtu edhe ato inovatore, nëpërmjet leksioneve, seminareve, detyrave të kursit, debateve, simulimeve si edhe formave të reja alternative nëpërmjet mjeteve vizuale bashkëkohore. Aty nxitet mendimi kritik dhe analizat nëpërmjet diskutimeve dhe debateve. Përdorimi i këtyre formave na u konfirmua edhe prej vetë studentëve përgjatë vizitës në institucion. Studenti vlerësohet nëpërmjet provimeve të ndërmjetme, provimeve përfundimtare dhe temës së diplomës.

	<i>(Ref: Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve Master Shkencor Politika publike dhe BE; Evidenca 1.7 Rregullore e Programit te Studimit Master i Shkencave ne Adm. Publik me profile 1).</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Personeli akademik është shumë i ndjeshëm dhe i kujdesshëm ndaj nevojave të studentëve dhe i përkushtohet mësimdhënies me forma e mënyra tradicionale dhe alternative si debate, simulime, etj. Përdorimi i këtyre formave alternative na u konfirmua edhe prej vetë studentëve përgjatë vizitës në institucion. Nuk ka pasur raste diskriminimi te studentët <i>(Ref: Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve Master Shkencor Politika publike dhe BE; Evidenca 1.7 Rregullore e Programit te Studimit Master i Shkencave ne Adm. Publik me profile 1).</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës.	Albanian University e mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike nëpërmjet shkëmbimeve të personelit akademik në projekte të ndryshme, trajnime, nxitjen në kërkimin shkencor, pjesëmarrjes në konferenca etj., si edhe në aplikime dhe mobilitet në kuadrin e programit Erasmus <i>(Ref: Evidenca 2.12. Aplikimi ne projekte Erasmus + etj; Evidenca 2.12. Aplikimi ne projekte Erasmus +, Virtu EU)</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në këtë program është tejet i kualifikuar dhe kompetent për të realizuar lëndët e këtij programi. Disa pedagogë të këtij programi vijnë me një CV të pasur në botën akademike si dhe me një eksperiencë të konsiderueshme në administratën publike e private (evidenca 3.1). Kjo bën që studenti të jetë i interesuar për të ndjekur leksionet pasi atyre iu përcillet edhe eksperiencia praktike, krahas teorisë. Disa të tjerë pedagogë që japin mësim në këtë program zotërojnë përgatitje të larta teorike, në linjë me nevojat e këtij programi. Studenti është në qendër të këtij programi. Synohet nxitja tek studentët të mendimit krijues, atij kritik si dhe autonomia e përgjegjshmëria e tyre. AU siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes studentëve dhe pedagogëve. Gjatë vizitës në institucion u vu re një marrëdhënie shumë e mirë mes studentëve dhe pedagogëve të këtij programi dhe një mirënjohje e lartë nga ana e studentëve për mësimdhënësit e tyre dhe mbështetjes të pakufijshme që ata iu kishin ofruar <i>(Ref: Evidenca 3.1. Curriculum Vitae te personelit akademik te angazhuar ne mesimdhenie; Evidenca 3.1. Curriculum Vitae te personelit akademik te angazhuar ne mesimdhenie).</i>

Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	DSHJPA ka si synim të përmirësojë format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre të cilat merren nëpërmjet pyetësorëve nga NJSBC dhe focus-grupeve (Evidence 3.2 a dhe b, Evidencë 3.3). Gjithashtu <i>feedback-u</i> i studentëve merret edhe nëpërmjet përfaqësuesve në Këshillin studentor, kryetari i të cilit është edhe pjesë e senatit <i>(Ref: Evidenca 3.2. a Rezultatet e pyetësorit drejtuar studentëve për mësimin online v.a. 2019 – 2020; Evidenca 3.2. b Rezultatet e Fokus grupeve; Evidenca 3.3 Shembull pyetësori ne platformen Teams).</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	NJSBSC është shumë aktive në Albanian University (evidence 1.1 a, b). Kjo njësi në punën e saj mbështetet nga Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave (evidence 1.1 a, b) dhe Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin (evidence 3.5). Në nivel njësie bazë, Përgjegjësi i Departamentit dhe Koordinatori i programit sigurohen që të sigurohet cilësi në mësimdhënie nëpërmjet përfshirjes së metodave të reja të mësimdhënies. Stafi mësimdhënës mbështetet nga Institucioni në trajnime e specializime por edhe për publikime shkencore dhe kërkimi shkencor në vija më të përgjithshme nga Fondi në mbështetje të botimeve në revista me Scopus dhe faktor impakti nga kërkuesit shkencorë i vënë në dispozicion nga AU për pedagogët e këtij institucioni <i>(Evidenca R.1.a). Ref: Evidenca 3.5 Rregullore e Fakultetit te Shkencave Shqiptore; Evidenca 1.1.a Statuti AU; Evidenca 1.1.b Statuti i miratuar korrik 2023; R.1.b Fondi në mbështetje të botimeve në revista me Scopus dhe faktor impakti nga kërkuesit shkencorë.</i>
Konkluzione	DSHJPA synon të përmirësojë format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces, duke i dhënë përparësi NJSBSC-së dhe duke mbështetur stafin mësimdhënës me trajnime e specializime por edhe për publikime shkencore dhe kërkim shkencor. Lipset që këto mundësira të bëhen pjesë organike e DSHJPA-së duke u parashikuar në rregullore dhe jo vetëm në një fond të caktuar për kërkimin shkencor i cili mund të jetë i fundëm.

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyrat e testimit të studentëve bazohen në Rregulloren e programit të studimit (evidence 1.7), në Rregulloren e Institucionit (evidence 1.2 a dhe b) dhe në Rregulloren e Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative (evidence 1.4). Mënyrat e vlerësimit të dijes si provimet e ndërmjetme dhe ata përfundimtarë, janë të shprehura qartë në syllabuset e lëndëve dhe iu bëhen të ditur studentëve nëpërmjet këtyre të fundit (evidence 2.2 a e b). (Ref: Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative; Evidenca 1.7 Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Adm. Publik me profile 1; Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve Master Shkencor Politika publike dhe BE; Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve Master Shkencor Politika publike dhe Qeverisje).
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Syllabuset e lëndëve, të cilët përmbajnë metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore, iu bëhen të ditur studentëve në çdo fillim lënde. Syllabuset (evidence 2.2) dhe Kodi i Etikës (evidence 3.6) iu bëhen të qartë studentëve përgjatë javës së parë të leksioneve për çdo semestër. Informacioni mbi çdo lëndë dhe mbi programin e saj mund të aksesohet përgjatë gjithë vitit në website-n e institucionit gjithashtu (Ref: 2.2. Syllabuset e lendeve Master Shkencor Politika publike dhe BE; Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve Master Shkencor Politika publike dhe Qeverisje; Evidenca 3.6 Kodi i Etikës).
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit	Testimi e vlerësimi i njohurive realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, të parashikuara nëpër syllabus-e si për shembull nëpërmjet provimeve të ndërmjetme, detyrave të kursit, projekteve, sipas mënyrës së përshkruar nëpër syllabus-et përkatëse të lëndëve. Informacioni mbi çdo lëndë dhe mbi programin mund të aksesohet përgjatë gjithë vitit në website-n e institucionit




të demonstrojnë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	(Ref: 2.2. Syllabuset e lendeve Master Shkencor Politika publike dhe BE; Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve Master Shkencor Politika publike dhe Qeverisje).			
Konkluzione	Kriteret dhe mënyrat e testimit janë të larmishme dhe mundësojnë long-time learning përgjatë të gjithë programit. Ato janë të shprehura qartë në syllabuset e lëndëve dhe iu bëhen të ditura studentëve nëpërmjet këtyre të fundit. Informacioni mbi çdo lëndë dhe mbi programin mund të aksesohet përgjatë gjithë vitit në website-n e institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Testimi e vlerësimi i njohurive realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, nëpërmjet provimeve të ndërmjetme, detyrave të kursit, projekteve, sipas mënyrës së përshkruar nëpër syllabus-et përkatëse të lëndëve (Ref: 2.2. Syllabuset e lendeve Master Shkencor Politika publike dhe BE. Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve Master Shkencor Politika publike dhe Qeverisje).
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni aplikon sistemin elektronik PITAGORA për hedhjen e rezultateve dhe kalkulimin e tyre (3.7) dhe kryen të gjitha procedurat sipas rregullave të parashikuara nga departamenti (evidenca 1.2 a, b). Sistemet elektronike të testimit nuk janë të aplikueshme për provime me shtjellime të çështjeve dhe jo me alternativa, ndaj korrigjimi manual përdoret më shpesh në shkencat sociale. (Ref: Evidenca 3.7 Manual i përdorimit të Pitagorës; Evidenca 1.2.a Rregullore e AU e vjeter; Evidenca 1.2.b. Rregullore AU perditësuar).
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me	Mënyra e vlerësimit të studentëve në programin Master i Shkencave në "Administrim Publik" me profile a. Politika Publike dhe BE, dhe b. Politika publike dhe qeverisje (MShAP) kryhet

syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	duke u bazuar në atë që parashikojnë syllabus-et e lëndëve përkatëse, në më të shumtën e rasteve, një shumatore e pikëve të frekuentimit, provimeve të ndërmjetme dhe atij final e duke i konvertuar më pas pikët në notën përfundimtare <i>(Ref: Evidenca 1.7 Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Adm. Publik me profile 1; Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve Master Shkencor Politika publike dhe BE; Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve Master Shkencor Politika publike dhe Qeverisje).</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Pedagogët e lëndëve, pas vlerësimit të provimeve, realizojnë të ashtuquajturën procedurë të ballafaqimit me provimin, ku studenti merr <i>feed-back</i>-un e duhur. Më pas notat hidhen në procesverbalin, brenda afateve të caktuara. Studenti mund të ankimojë vlerësimin dhe në raste të veçanta ngrihet një Komision rivlerësimi <i>(Ref: Vizita në AU, Evidenca 1.7 Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Adm. Publik me profile 1; Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve Master Shkencor Politika publike dhe BE; Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve Master Shkencor Politika publike dhe Qeverisje).</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Procedura e zhvillimit të provimeve parashikon monitorimin e sallës si edhe mospërdorimin e celularëve. Kopja dhe plagjatura janë të dënueshme sipas rregulloreve dhe kodit etik dhe studentët informohen për këto penalizime që në fillim të vitit akademik nëpërmjet rregullave të shkruara në Syllabus-e, Rregullores së Programit dhe në Manualin për punimin e temave të diplomave <i>(Ref: Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve Master Shkencor Politika publike dhe BE; Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve Master Shkencor Politika publike dhe Qeverisje Evidenca 3.9 Manuali për punimin e temave të diplomës; Evidenca 1.7 Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Adm. Publik me profile 1).</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen brenda 7 ditëve, sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u	Studenti ka të drejtë të ankimojë vlerësimin e provimit. Në këto raste, ngrihet një Komision <i>ad-hoc</i> për rishikimin e vlerësimit dhe është trajtuar çështja sipas rastit përkatës (evidencë 1.7).

njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studentët, gjatë vizitës në institucion, u shprehën se kjo procedurë ka funksionuar mirë përgjatë të gjithë kohëzgjatjes së programit dhe se zëri i tyre është dëgjuar në rastet kur kanë pasur ankime në lidhje me provimin e kryer (Ref: Vizita në AU; Evidenca 1.7 Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Adm. Publik me profile 1).			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Siç u përmend edhe gjatë takimit me studentët e këtij programi, ka pasur raste ankimesh dhe ato janë tarjtuar në përputhje me rregulloren e programit. Menjëherë është ngritur një Komision <i>ad-hoc</i> për rishikimin e vlerësimit, sapo studenti ka bërë kërkesë për rishikim të vlerësimit (Ref: Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Adm. Publik me profile 1).			
Konkluzione	Mënyra e vlerësimit të studentëve në programin Master i Shkencave në "Administrim Publik" me profile a. Politika Publike dhe BE, dhe b. Politika publike dhe qeverisje (MShAP) kryhet duke u bazuar në parashikimin e në syllabus-e dhe në rregulloret përkatëse, duke i dhënë rëndësinë e duhur procesit të ballafaqimit të studentit me vlerësimin dhe procedurës së ankimit të këtij vlerësimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit i këtij Masteri Shkencor nëpërmjet dimensionit teorik dhe shkencor të tij, garanton thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësimit për kërkim shkencor të studentëve që ndjekin këtë Master. Në këtë program i vihet një rëndësi e veçantë njohjes së studentëve me administratën publike, sistemeve politike, politikave publike, por njëkohësisht edhe aftësimit të tyre ndaj mendimit kritik nëpërmjet simulimeve, detyrave të kursit, debateve dhe praktikës nëpër institucione

	(Ref: Evidenca 2.1. Evidenca 2.1 Plani mesimor i Programit te studimit Master i Shkencave; Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve Master Shkencor Politika publike dhe BE; Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve Master Shkencor Politika publike dhe Qeverisje).
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit është i konceptuar në mënyrë tradicionale, por njëkohësisht me hapësirën e duhur për t’ju përshtatur kohës dhe zhvillimeve teknologjike. Këtë mundësi e ofron jo vetëm kurrikula e konceptuar për këto zhvillime, por edhe fasilitetet që vijnë prej laboratorëve dhe instrumentave të tjerë teknologjik që ofron Albanian University në funksion të studentëve të regjistruar. Gjithashtu programi i këtij Masteri shkencor ofron lëndë që ndikojnë në aftësitë komunikuese të studentëve të tij si Teoria dhe Praktika e Lidershipit, Komunikim Institucional etj. (Ref: Evidenca 2.1 Plani mesimor i Programit te studimit Master i Shkencave; Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve Master Shkencor Politika publike dhe BE; Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve Master Shkencor Politika publike dhe Qeverisje).
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Syllabuset e çdo lënde janë të hartuara me kujdes nga titullarët e lëndëve. Aty janë paraqitur me saktësi kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti në përfundim të asaj lënde dhe janë specifikuar çështjet më të rëndësishme, literatura bazë dhe ajo e sugjeruar, si edhe detyrimet përmbyllëse të studentit. (Ref: Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve Master Shkencor Politika publike dhe BE; Evidenca 2.2. Syllabuset e lendeve Master Shkencor Politika publike dhe Qeverisje).
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në	Mësimdhënia zhvillohet duke pasur parasysh se çfarë do tu duhet studentëve në teori si dhe në praktikë e në kërkim shkencor, duke qenë ky një program Masteri shkencor. Personeli akademik zhvillon diskutime dhe punë në grup, edhe sipas dëshmimeve të studentëve përgjatë takimit me ta të GVJ-së. Studentët, siç u tregua edhe përgjatë këtij takimi, ishin të lirshëm, pa komplekse, të kënaqur nga puna e pedagogëve, nga nxitja e tyre për studim e thellim të mëtejshëm, si edhe për mendim kritik dhe diskutime.

interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Të gjithë këta elementë janë tregues të një klime pozitive në institucion. Mobiliteti i studentëve, i nxitur prej pedagogëve të tyre, ka qenë relativisht i shpeshtë në këtë program, kjo e mundësuar edhe prej karakterit këtij programi të shtrirë në dy vite <i>(Ref: Evidenca 2.13. Mobiliteti i studenteve).</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik si dhe ai me kontratë realizon leksione të hapura dhe seminare, aktivitete të larmishme në IAL sipas evidencës 1.8 e cila përshkruan aktivitetet ekstrakurrikulare të zhvilluara në vitet e fundit. Në këto aktivitete kanë qenë të ftuar ekspertë kombëtarë si B.Çejku, E. Karamuço, A. Krasniqi etj., si edhe janë trajtuar tema me interes për studentët e këtij program, nga vendi dhe bota dhe të lidhura me përmirësimin e qeverisjes dhe të politikave publike <i>(Ref: Evidenca 1.8 Aktivitete Ekstrakurrikulare).</i>
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Albanian University nxit dhe mbështet studentët përgjatë të gjithë rrugëtimit të tyre, në ide inovative dhe projekte kërkimore. Konferenca studentore është një shembull i mirë në këtë drejtim, gjithashtu edhe aktivitetet e tjera sipas listës së aktiviteteve ekstrakurrikulare (evidencë 1.8), panairi i punës Work&Study (evidencë 5.4) dhe leksioneve të hapura mbi nxitjen e studentëve për punësim <i>(evidencë 5.8 dhe 5.9) (Ref: Evidenca 1.8 Aktivitete Ekstrakurrikulare; Evidenca 5.4 Panairi Work & Study; Evidenca 5.8 Leksion i hapur "Si të punësohesh; Evidenca 5.9 Leksion i hapur për nxitjen e studentëve për punësim).</i>
Konkluzione	Mësimdhënia zhvillohet duke pasur parasysh se çfarë do të duhet studentëve në profesionalizëm dhe kërkim shkencor, duke u mbështetur në një personel akademik të përgatitur i cili nxit diskutimet, menimin kritik dhe punën në grup. Albanian University nxit dhe mbështet studentët përgjatë të gjithë rrugëtimit të tyre, në ide inovative dhe projekte kërkimore.

	Personeli akademik si dhe ai me kontratë realizon leksione të hapura dhe seminare, aktivitete të larmishme në IAL, në funksion të studentëve dhe integrimit të tyre në tregun e punës apo kërkimit shkencor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Studimet e Master Shkencor në “Administrim Publik” me profile a. Politika Publike dhe BE, dhe b. Politika publike dhe qeverisje (MShAP) përmbyllen me temë diplome, sipas Rregullores së AU-së (evidencë 1.2 a dhe b), Rregullores së Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative (evidencë 1.4), Rregullores së Programit të Studimit (evidencë 1.7) dhe Rregullores së Diplomimit (evidencë 3.8). Procedura e provimit të formimit ose diplomimi janë të përshkruara qartë në këto dy të fundit. (Ref: Evidenca 1.2.a Rregullore e AU e vjeter; Evidenca 1.2.b. Rregullore AU perditësuar; Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative; Evidenca 1.7 Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Adm. Publik me profile; Evidenca 3.8 Rregullore e Diplomimit).
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Çdo studenti që kërkon të realizojë një temë diplome, i vendoset në dispozicion një udhëheqës/e diplome i/e cili/a e orienton me temën dhe literaturën, si edhe një Manual mbi hartimin e temave të diplomave (Evidencë 3.8). Gjatë vizitës në institucion, studentët u shprehën shumë të kënaqur në lidhje me të gjithë procedurën e hartimit të temave të diplomave si edhe atë të diplomimit. Ata folën me pasion për atë periudhë të rrugëtimit të tyre si edhe për temat e diplomave, hulumtimin e kryer dhe mbështetjen e pakursyer të pedagogëve të tyre (Ref: Evidenca 3.8 Rregullore e Diplomimit).
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin	Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final miratohet nga Dekani pas propozimit prej përgjegjësit të Departamentit sipas shkresës për ngritjen e këtij Komisioni (Evidencë 3.10). Më pas, procedura e vlerësimit konsiston në vlerësimin e disa aspekteve

e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	kryesore të temës së diplomës si cilësia e kërkimit shkencor, struktura dhe origjinaliteti. (evidencë 3.11) (Ref: Evidenca 3.10 Shkresa per ngritjen e komisionit te diplomimit; Evidenca 3.11. Shembull procedure diplomimi).
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Studentët që do të kryejnë një punim diplome udhëhiqen nga një pedagog/e i/e departamentit. Udhëheqësi/ja e mbështet studentin/en përgjatë këtij rrugëtimi me literaturë dhe të gjithë orientimin e nevojshëm dhe më pas e miraton punimin për dorëzim. Në përdorim të studentëve është vendosur një manual "Si të shkruajmë një temë diplome". Procedura e dorëzimit të temës së diplomës është e parashikuar në Rregulloren e programit dhe të Departamentit (evidencë 3.8) dhe në atë të Sekretarisë mësimore (evidencë 3.12). Përgjatë takimit me student në IAL, studentët u shprehën shumë të kënaqur me përkushtimin e pedagogëve të tyre si në udhëheqjen e temave të diplomave, ashtu edhe në orientimin dhe ndihmesën në lidhje me gjetjen e literaturës për diplomim (Ref: Evidenca 3.8 Rregullore e Diplomimit; Evidenca 3.12 Rregullore e sekretarise mesimore).
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	AU ofron laborator informatike për studentët të cilin GVB-ja pati rastin ta vizitonte gjatë vizitës në Institucion. Ky laborator mund të përdorej edhe nga studentët të cilit ishin duke kryer temat e diplomave. Studentët ndihmoheshin nga udhëheqësit e tyre të diplomave në rastet kur duhej të hartoheshin pyetësorë apo të kryheshin analiza për temat e tyre të diplomave (Evidenca 3.8 Rregullore e Diplomimit).
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Për vlerësimin e provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të punimit të diplomës përdoret një skedë në pikë për vlerësimin. Këto pikë konvertohen në notë dhe pasi nota është vendosur në procesverbal, i bëhet me dije studentit të interesuar brenda 72 orëve. Kjo procedurë është e parashikuar në Rregulloren e programit dhe të Departamentit (evidencë 3.8) dhe në atë të Sekretarisë mësimore (evidencë 3.12) (Ref: Evidenca 3.8 Rregullore e Diplomimit; Evidenca 3.12 Rregullore e sekretarise mesimore).
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe	Në përfundim të studimeve, studentët e Masterit të Shkencave në "Administrim Publik" me profile a. Politika Publike dhe BE, dhe b. Politika publike dhe qeverisje (MShAP) pajisjen me diplomën

suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	dhe suplementin e diplomës. Suplementi është në shqip dhe anglisht. Me kërkesë të tij, studentit mund ti vihet në dispozicion kopje e plotë e programit të studimit, pra syllabus-et e lëndës në përputhje me vitin akademik ku këto lëndë janë zhvilluar sipas Rregullores së Sekretarisë Mësimore (Ref: Evidenca E.1. Diploma Master Shkencave ne Administrim publik, Politika publike dhe BE; Evidenca E1 Diploma Master Shkencave ne Administrim publik, Politika publike dhe qeverisje; Evidenca E2 Lista e notave dhe Supplement Politika publike dhe BE; Evidenca E.2. Lista e notave dhe Supplement Politika publike dhe Qeverisje; Evidenca 3.12 Rregullore e sekretarise mesimore).			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Institucioni ruan kopje të dokumentacionit të studentit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen sipas Rregullores së Sekretarisë Mësimore. (Ref: E.1. Diploma Master i Shkencave në "Administrim publik", Politika publike dhe BE; Evidenca E.1. Diploma Master Shkencave ne Administrim publik, Politika publike dhe qeverisje; Evidenca E.2. Lista e notave dhe Supplement Politika publike dhe BE; E.2. Lista e notave dhe Supplement Politika publike dhe Qeverisje).			
Konkluzione	Çdo student i që merr të realizojë një temë diplome, i vendoset në dispozicion një udhëheqës/e diplome i/e cili/a e orienton me temën dhe literaturën, një Manual mbi hartimin e temave të diplomave si dhe një laborator për të punuar temën e diplomës në rast nevojë. Procedura për diplomimin është e qartë. Gjithashtu, edhe ajo për tërheqjen e diplomës apo të suplementit të diplomës sa herë që student i e kërkon është shumë e thjeshtuar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive,	NA

garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.				
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	NA			
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	NA			
Konkluzione				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Fusha akademike e lektorëve të angazhuar në programin e studimit Master Shkencor në “Administrim Publik” me profile a. Politika Publike dhe BE, dhe b. Politika publike dhe qeverisje (MShAP) ofruar nga IAL “Albanian University” (AU) është në përputhje me modulet dhe lëndët ku ata janë aktivizuar. Personeli akademik i angazhuar ka një eksperiencë disavjeçare në mësimdhënie edhe në fushën kërkimore. Kjo vërtetohet edhe nga shqyrtimi që GVJ u bëri CV akademike të stafit akademik, me angazhime dhe botime. Në këtë program studimi numri i stafit akademik i angazhuar nga IAL në Departamentin e Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative është për vitin akademik 2023-2024 është: 13 Personal Akademik Efektiv (PAE), me kohë të plotë, dhe 18 Personal Akademik me Kontratë (PAK), me kohë të pjesshme. Pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore është i depozituar dokumentacioni për stafin e angazhuar. Zyra e Burimeve Njerëzore e mban CV, kontrata, diploma, dhe të dhënat tjera të personalit të angazhuar në programin e studimit. Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative (DSHJPA), si njësi bazë, dhe Fakulteti i Shkencave Shoqërore (FSSH), si njësi kryesore, mban evidencë për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semestër. GVJ vlerëson se personeli PAE dhe PAK që angazhohet në realizimin e programit të studimit MShAP ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik dhe përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. Ata përmbushin kërkesën ligjore që stafi i angazhuar duhet të ketë një nivel kualifikim të duhur për ciklin e dytë të studimeve. Ky vlerësim bazohet në shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Mbrendshëm (RVB), dosjeve të personelit në takimin me Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe në takimin e drejtpërdrejtë me stafin akademik dhe atë ndihmës akademik, ku titullarët e lëndëve janë me gradën shkencore Dr. ose me titujt akademikë profesor ose profesor i asociuar. Megjithatë, stafi akademik ose DSHJPA nuk ka pasur një fushë të përbashkët kërkimore që ka të bëjë me të gjithë stafin akademik të përfshirë në programin e studimit ose departamentit. Stafit akademik i mungon një fokus i përbashkët kërkimor që do të përfshinte të gjithë anëtarët pjesëmarrës në programin e studimit. Stafi akademik i departamentit mund të konsiderojë të ketë një fushë(a) të përbashkëta kërkimore që do të unifikonin të gjithë anëtarët e stafit akademik të përfshirë në programin e studimit

	Kualifikimi i stafit akademik të programit të studimit	2022-2023		2023-2024	
		PAE	PAK	PAE	PAK
	Prof.Dr				
	Prof.As.Dr	2	2	2	2
	Dr	5	1	4	2
	MSc		2		
	Total	7	5	6	4
(Ref. RVB, fq. 33; RVB Aneks - Tabelat Përmbledhëse; Evidencë 3.1. – Curriculum Vitae të personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie; Evidencë 4.2.a. - Kontrata PAE; Evidencë 4.2.b. - Kontrata PAK; Takimet me stafin akademik dhe me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore).					
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Stafi akademik efektiv përmbushë ngarkesën mësimore për programin e studimit MSAP në përputhje me kuadrin ligjor përkatës. Kjo siguron që të gjitha detyrat mësimore të përmbushen sipas standardeve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe AU. PAE mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit MShAP në përputhje me Udhëzimi Nr. 29 datë 10.9.2018 të MAS, si edhe në rregulloret të AU. Lëndët e programit MShAP mbulohen mbi 70% nga PAE. Niveli i kualifikimit dhe fushat akademike-kërkimore të tyre i përgjigjen natyrës dhe specifikave të lëndëve e moduleve që ata zhvillojnë				
	2022-2023		2023-2024		
	PAE	PAK	PAE	PAK	
Ndarja e ngarkesës mësimore	69.59%	30.41%	70.05%	29.95%	

	(Ref. RVB, fq. 33; Evidencë 4.1. – Ngarkesa mësimore e stafit; Takimi me stafin akademik).
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	AU siguron dhe demonstroi qëndrueshmërinë e stafit të tij akademik të përfshirë në programin e studimit MShAP me profile gjatë gjithë periudhës së akreditimit. GVJ gjatë vizitës në AU në takimin me burimet njerëzore dhe bisedën me stafin PAE dhe PAK konstatoi se personeli akademik i angazhuar në realizimin e këtij programi studimi kanë një angazhim disaveçar në kurset përkatëse, dhe personeli akademik kanë vitet e duhura si PAE në AU duke kaluar shkallët e karrierës akademike. Kontratat e punësimit ishin sipas kërkesave të Kodit të Punës duke mbuluar me sigurime shoqërore dhe shëndetësore të gjithë. Në kontratat janë të përcaktuara kohëzgjatja dhe të drejtat dhe detyrat e stafit akademik dhe të institucionit (Ref. RVB, fq. 33; Evidencë 4.2.a. - Kontrata PAE; Evidencë 4.2.b. - Kontrata PAK; Takimet me stafin akademik dhe me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore).
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	AU zakonisht ndjek procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të dizajnuara për të siguruar që personeli i përzgjedhur të ketë kualifikimet e duhura dhe të përputhet me kërkesat e programit të studimit. AU vendos kriteret transparente dhe të përcaktuara qartë për rekrutim. Kriteret e përgjithshme mund të përfshijnë kualifikimet akademike, përvojën përkatëse të mësimdhënies ose kërkimit shkencor dhe kompetencat e demonstruara. Kriteret specifike përputhen me natyrën e programit të studimit MShAP me profile , duke adresuar ekspertizën e kërkuar për module të veçanta ose fusha të përmbajtjes. Këto kriteret shpallen publikisht përmes kanaleve të ndryshme p.sh., websaitit AU, për të arritur një grup të gjerë kandidatësh të kualifikuar. Komisioni i Vlerësimit pasi shqyrton kandidaturat i propozon Dekanit për miratim kandidatët e përzgjedhur, sipas një renditje të kandidatëve që plotësojnë më mirë kriteret dhe i përgjigjen përshkrimit të vendit të punës. Gjatë gjithë punësimit të tyre, personeli akademik zakonisht i nënshtrohet vlerësimeve të performancës për të siguruar përafrim të vazhdueshëm me objektivat e programit të studimit MShAP dhe standardet e cilësisë siç përcaktohet nga MAS dhe ASCAL. Duke ndjekur këto procedura, AU ruan një standard të cilësisë së mësimdhënies dhe siguron që stafi i përzgjedhur të jetë i përshtatshëm për të mbështetur qëllimet akademike të programit MShAP. Takimi i GVJ me stafin akademik provoi se ata janë titullarë të moduleve, lëndëve në përputhje me nivelin e kualifikimit të tyre dhe përmbajtjen e programit të studimit MShAP

	<i>(Ref. RVB, fq. 33-34; Evidencë 4.3. - Shembull i procedurës së rekrutimit; Takimet me stafin akademik dhe me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore).</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Pranë DSHJPA është angazhuar një (1) staf ndihmës akademik, i cili kujdeset për mbarrëvajtjen e procesit mësimor. Institucioni rekruton personel mbështetës bazuar në kualifikimet që plotësojnë këto role të përcaktuara. Kjo siguron që personeli mbështetës të jetë në gjendje të ndihmojë si pedagogët ashtu edhe studentët në mënyrë efektive, duke kontribuar në realizimin e programit të studimit MShAP. Për natyrën e programit të studimit MShAP nuk ka nevojë për orë laboratorike apo për mjedise të tjera specifike mësimore <i>(Ref. RVB, fq. 34).</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Të dhënat e personelit mbledhen, ruhen dhe përditësohen në dosjen individuale të stafit të Zyra e Burimeve Njerëzore në mënyrë sistematike, duke siguruar saktësinë dhe pajtueshmërinë me kërkesat ligjore. Informacioni mbi angazhimin e secilit anëtar të stafit regjistrohet te DSHJPA, duke specifikuar ngarkesën e tyre mësimore, detyrat semestrale, modulet e kursit dhe çdo përgjegjësi shtesë. Historia e angazhimit të çdo anëtarit të stafit, vit pas viti, është e dokumentuar për të siguruar një regjistrim të qartë të përfshirjes së tyre në program me kalimin e kohës. Raportet e përmbledhura për personelin përgatiten çdo vit dhe përdoren për përgatitjen e raportit vjetor të IAL dhe raportohen në MAS. Të dhënat lidhur me anëtarët e personelit akademik ruhen dhe azhurnohen të paktën një herë në vit në arkivën e Zyrës së Burimeve Njerëzore, si dhe në atë të DSHJPA. "Do të ishte mirë që për këtë qëllim të kishte një Zyrë të veçantë të menaxhimit të burimeve njerëzore i dedikuar në mënyrë specifike vetëm për stafin akademik dhe administrativ në ndihmë të AU". <i>(Ref. RVB, fq. 34; Takimi me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore).</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e	AU, FSHS si dhe DSHJPA, bashkëpunojnë me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues të biznesit, kompani dhe organizata publike dhe jopublike për të siguruar personel të kualifikuar për mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punën e diplomës dhe aktivitete të tjera të specializuara në përputhje me qëllimet e programit të studimit MShAP. Praktikant zhvillohen

kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	brenda afatit të caktuar në kalendarin akademik, në institucionet me të cilat AU ka marrëveshje bashkëpunimi dhe nën drejtimin e një pedagogu të caktuar nga DSHJPA. Çdo pedagog ka nën mbikqyrje jo më shumë se 20 studentë. DSHJPA monitoron efektivitetin e kësaj përpjekjeje nëpërmjet komenteve nga studentët dhe vlerësimeve të tyre. Gjithashtu, takimet me organizatat partnere ndihmojnë DSHJPA të vlerësojë cilësinë e praktikës profesionale, duke siguruar që studentët të marrin udhëzime të vlefshme. AU dhe DSHJPA nënshkruajnë në mënyrë të vazhdueshme marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike, bashki, biznese dhe organizata të shoqërisë civile për praktikën profesionale, duke bërë rregullimet e nevojshme bazuar në reagimet dhe nevojat e studentëve. Aktualisht AU ka marrëveshje bashkëpunimi për zhvillimin e praktikave profesionale me disa institucione publike, universitete, organizata dhe biznese për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve, duke përfshirë Departamenti i Administratës Publike, Kuvendi i Shqipërisë, Akademia e Shkencave, Kontrolli i Lartë i Shtetit, etj.			
	(Ref. RVB, fq. 34; RVB Aneks - Tabelat Përmbledhëse - Tabela 5).			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Institucioni pritës përcakton një udhëheqës i cili kontrollon dhe informon mbi mbarëvajtjen e praktikës. Personeli mbikqyrës ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve. Mbikëqyrësit u ofrojnë studentëve një orientim gjithëpërfshirës në lidhje me mjedisin pritës, duke përfshirë pritshmëritë specifike, rolet dhe burimet në dispozicion për të mbështetur praktikën e tyre profesionale. Për programet shkencore të ciklit të dytë, një rëndësi e veçantë i kushtohet aftësimin të studentëve për të realizuar, jo vetëm aplikimin e njohurive teorive, por edhe zhvillimin e aftësive praktike të tyre. Këto ofrojnë njohuritë e nevojshme për studentët që synojnë punësime në sektorët ku kanë kryer praktikën e tyre			
	(Ref. RVB, fq. 34; Takimi me studentët e programit të studimit).			
Konkluzione	GVJ konfirmon se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit i përmbahet standardeve të cilësisë dhe zotëron kualifikimet e nevojshme dhe të specializuara akademike që lidhen me fushën e programit. Kjo siguron që stafi mund të japë mësimdhënie të përditësuar dhe të kryejë kërkime shkencore që përputhen me fushat specifike që mbulon programi i studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	GVJ vizitoi mjediset e AU dhe vlerëson se IAL ka mjediset të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e programit të studimit në auditore. MShAP zhvillon aktivitetin në godinën kryesore në qendër të kryeqytetit Tiranë. Mjediset plotësojnë standardet e shëndetit dhe sigurisë dhe pajisjet janë në gjendje të mirë pune. Çdo cikël akademik, institucioni shqyrton të dhënat e regjistrimit të studentëve për të kuptuar numrin e studentëve dhe madhësinë e grupeve mësimore në secilin program. Institucioni mbledh rregullisht komente nga studentët dhe pedagogët mbi përshtatshmërinë e objekteve, duke lejuar rregullime dhe përmirësime të nevojshme. Çdo përmirësim, zgjerim ose rregullim i kërkuar është planifikuar në përputhje me disponueshmërinë e buxhetit. Kjo analizë ndihmon në ndarjen e duhur të hapësirës së klasave <i>(Ref. RVB, fq. 35; Evidencë 4.4. - Planimetritë e godinës; RVB Aneks - Tabelat Përmbledhëse - Tabela 16; Vizita te godina e AU).</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	GVJ gjatë vizitës në mjediset ku zhvillohej mësimi nga programi i studimit të IAL dhe biseda me stafin vlerëson se mjediset mësimore si auditoret janë të pajisura me pajisje elektronike për përdorimin e teknologjisë së informacionit. Të gjitha sallat janë të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike: kompjuter, videoprojektor dhe rrjet interneti wireless. Lëndët që integrojnë komponentë virtuale mbështeten nga klasa të pajisura me teknologji për të ofruar përvojat e të nxënit dixhital. DSHJA përdor platformën Microsoft Teams për t'u siguruar studentëve akses në materialet e kursit, detyrat dhe burimet online. Platforma gjithashtu lehtësojnë komunikimin midis instruktorëve dhe studentëve, duke mundësuar një qasje të përzier të të mësuarit. Stafi akademik marrin mbështetje në përdorimin e teknologjive të reja dhe metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies. Vlerësimet e rregullta të efektivitetit të teknologjisë kryhen përmes reagimeve nga studentët dhe pedagogët. Institucioni shpërndan burime buxhetore për të investuar në teknologji dhe përmirësimet e infrastrukturës, duke siguruar që mjediset mësimore të mbeten të përditësuar

	(Ref. RVB, fq. 35; Evidencë 4.4. - Planimetritë e godinës; RVB Aneks - Tabelat Përmbledhëse - Tabela 16; Vizita te godina e AU).
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Edhe pse ky program studimi nuk ka nevojë të ketë një laborator specifik, AU siguron laboratorë ose studio për nevojat specifike të programit të studimit. Klasat dhe sallat e konferencave janë me hapësira të mëdha dhe të gjithë ata janë të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike: kompjuter, videoprojektor dhe rrjet interneti wireless (Ref. RVB, fq. 35; Evidencë 4.4. - Planimetritë e godinës; RVB Aneks - Tabelat Përmbledhëse - Tabela 16; Vizita te godina e AU).
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	AU siguron një (1) laborator të teknologjisë së informacionit pajisur me mjete të teknologjisë për plotësimin e kërkesave të lëndëve, apo moduleve të programit të studimit MShAP, si dhe hulumtimit individual të studentëve, me një kapacitet prej 30 personash. Një punonjës i IT është në dispozicion të mirëmbajtjes së Laboratorit (Ref. RVB, fq. 35-36; Evidencë 4.4. - Planimetritë e godinës; RVB Aneks - Tabelat Përmbledhëse - Tabela 16; Vizita te godina e AU).
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të	AU dhe veçanërisht DSHJPA për të pasur bashkëpunime dypalëshe që i shërbejnë dijës, praktikës dhe realizimit të programit të studimit ka nënshkruar marrëveshje me institucione qeveritare dhe joqeveritare. Nëpërmjet këtyre partneriteteve, universiteti mund të ketë akses në objekte, pajisje dhe ekspertizë shtesë që mund të mos jenë të disponueshme te IAL, duke siguruar që studentët të marrin përvoja të praktikës profesionale. Bashkëpunimet me organizatat e komunitetit dhe bizneset lokale u mundësojnë studentëve të angazhohen në punë në terren dhe praktika, duke ofruar përvoja praktike në mjedise autentike. Studentët në vlerësimet e tyre reagojnë në lidhje me funksionalitetin dhe efektivitetin e objekteve për të bërë rregullime dhe përmirësime në kohë (Ref. RVB, fq. 36; Evidencë R.2 Marrëveshje të Departamentit në funksion të programit të studimit).

sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.				
Konkluzione	<i>GVJ konfirmon se AU ka në disponim mjedise të pajisura me infrastrukturë mësimore që janë të përshtatshme për zbatimin efektiv të programit të studimit. Ky mjedis është dedikuar për të përmirësuar përvojën arsimore dhe për t'u ofruar studentëve burimet e nevojshme për të mësuarit teorik dhe praktik. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje me aktorë të ndryshëm, duke përfshirë institucionet publike, bizneset, dhe organizatat e shoqërisë civile.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Gjuha e programit të studimit MShAP është Shqip. Universiteti siguron që literatura bazë dhe ndihmëse tu ofrohet studentëve, si në formatin fizik ashtu edhe atë digjital në gjuhën Shqipe, me qëllim të mbështesë përvetësimin e njohurive dhe të kuptuarit thelbësor, siç përshkruhet në programin e studimit. Tekstet kryesore, artikuj akademikë dhe burimet plotësuese zgjidhen për t'iu përshtatur rezultateve specifike të të nxënit të secilit kurs. Literatura mbulon të gjitha fushat kryesore të programit të studimit, duke siguruar që studentët të jenë të aftë për konceptet themelore dhe të avancuara. Të gjitha tekstet bazë dhe materialet plotësuese janë të disponueshme në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Biblioteka e AU është e pajisur me kopje fizike të teksteve thelbësore dhe materialeve plotësuese, të cilat studentët mund t'i huazojnë ose t'i qasen në terren për referencë. Baza të të dhënave akademike, p.sh. Cambridge Core, është të aksesueshme për studentët duke u mundësuar atyre akses të vazhdueshëm në materiale akademike. Duke ofruar këto burime në formatin fizik dhe digjital dhe në gjuhën e programit të studimit, universiteti siguron që studentët të fitojnë në mënyrë efektive njohuritë dhe kuptimin e nevojshëm për të arritur qëllimet akademike të programit MShAP

	<i>(Ref. RVB, fq. 36; Evidencë 2.7. - Procedura e pasurimit të bibliotekës; Evidencë 3.13. - Biblioteka online; Vizitë në Bibliotekë).</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	DSHJPA kryen rishikime periodike të literaturës në Bibliotekë si dhe te Planprogramet për tu siguruar që ata të mbeten aktuale me zhvillimet më të fundit akademike dhe të kërkimit shkencor. Gjithashtu, anëtarët e stafit akademik si dhe studentët rekomandojnë burime të reja <i>(Ref. RVB, fq. 36-37; Evidencë 2.5. - Procedura e rishikimit të syllabuseve; Evidencë 2.7. - Procedura e pasurimit të bibliotekës; Evidencë 3.13. - Biblioteka online; Vizitë në Bibliotekë).</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	FSHS vë në dispozicion të studentëve Bibliotekë mësimore në godinën e IAL në qendër të Tiranës, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë. Ajo është pjesë e integruar të Bibliotekës. Ambienti i dedikuar ofron hapësira të mjaftueshme për lexim dhe studim nga ana e studentëve <i>(Ref. RVB, fq. 37; Evidencë 4.4.; Vizitë në Bibliotekë).</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.	GVJ gjatë vizitës në Bibliotekë konstatoi se ajo është e pajisur me fond fizik e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaj. Biblioteka vë në dispozicion të studentëve 120 tituj librash në fushat e shkencave juridike dhe politike e administrative <i>(Ref. RVB, fq. 37; Vizitë në Bibliotekë).</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në	Mjediset e bibliotekës fizike ishin të mjaftueshme për numrin e vogël të studentëve të këtij programi studimi, kurse biblioteka online ishte pa pagesë. Biblioteka e ndodhur në bodrumin e ndërtesës që GVJ vizitoi kishte vende qendrimi pa kompjutera, ngjitur me të ishin dy kompjutera që mund ti përdornin studentët

bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	për aksesimin e Bibliotekës online si Cambridge Core, një nga bibliotekat online që ofron Libra universitare dhe artikuj shkencor elektronikë nga Universiteti i Kembrixhit dhe të tjera universitete të njohura botërore (Ref. RVB, fq. 37; RVB Aneks - Tabelat Përmbledhëse - Tabela 17; Vizitë në Bibliotekë).
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka plotëson nevojat e studentëve për literaturë bazë dhe ndihmëse duke ofruar edhe versionin on-line në mënyrë të barabartë për të gjithë studentët. Megjithatë, aksesimi i Bibliotekës online sigurohet vetëm brenda institucionit, dhe jo jashtë ambienteve të universitetit (Ref. RVB, fq. 37; RVB Aneks - Tabelat Përmbledhëse - Tabela 17; Vizitë në Bibliotekë).
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka ishte në dispozicion të studentëve në oraret e funksionimit të AU, sipas nevojave të studentëve, sikurse u konfirmua nga biseda me bibliotekaren. Orari i punës në bibliotekë është nga ora 8 deri 4 pasdite çdo ditë nga e hëna në të premte, dhe ditën e shtunë nga ora 8 deri 12. Biblioteka poashtu sipas nevojave vihet në dispozicion edhe gjatë orareve të pasdites nga ora 16 deri 20. Oraret shpallen në mjediset e institucionit dhe në faqen online të universitetit (Ref. RVB, fq. 37; Vizitë në Bibliotekë).
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa	Institucioni vazhdon traditën me planifikimin vjetor për blerjen e literaturave bashkëkohore për realizimin e programit të studimit për shtimin dhe përditësimin e zërave të bibliotekës. Çdo student dhe lektor ka të drejtë të përdorë kompjuterat e bibliotekës për burimet elektronike. Megjithatë, përdorimi i katalogut elektronik të bibliotekës është i kufizuar te kompjuteri i bibliotekares (Ref. RVB, fq. 37-38; Vizitë në Bibliotekë).

të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.				
Konkluzione	GVJ ka përcaktuar se Biblioteka e AU ofron një përzgjedhje të mirë të literaturës për studentët si pjesë e programit të studimit. Ajo, gjithashtu, ofron akses në burimet online. Këto burime digjitale janë të aksesueshme për të gjithë përdoruesit, por vetëm brenda kampusit dhe jo në uebfaqen të universitetit. Balancimi i burimeve digjitale me një bibliotekë fizike të përditësuar vazhdimisht për të ofruar një sistem mbështetës më të plotë për nevojat e mësimi të studentëve dhe mësimdhënies është i rëndësishëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Gjatë vizitës në institucion dhe shqyrtimit të një sërë dokumentesh, GVJ vlerëson se strukturat akademike dhe administrative në AU, nga sekretariteti deri tek zyrat e zyrat e këshillimit, sigurojnë administrimin e gjithë informacionit në lidhje me studentët, nga regjistrimi për studentët e rinj, informimi në mënyrë të vazhdueshme për oraret, lëndët, provimet, mundësitë që ata kanë për trajnime, mobilitete apo praktika profesionale gjatë kohëzgjatjes së studimeve të tyre, deri në diplomim. Institucioni përdor një sistem gjithëpërfshirës të menaxhimit që administron të gjithë informacionin në lidhje me studentët nga regjistrimi deri në diplomim. GVJ shqyrtoi nëpër Regjistrat standard një bazë të dhënash të plota e të përditësuara mbi studentët të tilla si: gjeneralitetet, datëlindja, programi i studimit që ndjekin, viti i studimit, shkolla e mesme nga kanë ardhur, notat e fituara përgjatë ciklit të studimeve, kontaktet, datën e rregjistrimit në universitet, datë çrregjistrimi dhe transferimi (për ata që ndërpresin studimet ose që transferohen nga IAL të tjera), dhe datën e diplomimit. Ky sistem ofron menaxhim të efektshëm, të sigurt dhe efikas të të

	dhënave gjatë gjithë rrugëtimit akademik, duke mundësuar akses të pandërprerë në informacion për studentët. Një dritare dixhitale e këtyre të dhënave pasqyrohet edhe në platformën online “Pitagora” (http://au.pitagora.rash.al), duke mbuluar të dhënat akademike, detajet personale, historinë e regjistrimit dhe oraret e kurseve. Megjithatë, transkriptet publikohen vetëm në Shqip. Duke pasur parasysh se studentët mund të dëshirojnë të shkojnë për mobilitet ose të vazhdojnë studimet e tyre më tej, është një praktikë e mirë që të lëshohet transkripti edhe në Anglisht në çdo kohë kur kërkohet nga një student <i>(Ref. RVB, fq. 38; Evidencë 3.12. - Rregullore e sekretarisë mësimore; Takimi me Sekretarinë Mësimore).</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Gjatë vizitës në AU, Zyra e Burimeve Njërezore u vuri në dispozicion GVJ të dhënat që përmbajnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, dhe personelit administrativ të angazhuar në realizimin e programit të studimit MShAP. Informacionet lidhur me partnerët e angazhuar në realizimin e bashkëpunimeve ruhen në DSHJPA dhe në zyrat përkatëse siç janë Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, dhe Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike. Megjithatë, nuk ka një sistem elektronik të menaxhimit që ka të bëjë me stafin <i>(Ref. RVB, fq. 38; Takimi me Zyrën e Burimeve Njërezore).</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Gjatë vizitës në AU, GVJ bëri kërkesën për aksesin në dokumente dhe informacione për persona të caktuar nga stafi akademik me zgjedhje rastësore dhe Zyra e Burimeve Njërezore u përgjigj pa hezitim; po ashtu Sekretaria Mësimore siguroi të dhëna të dedikuara për studentët të MShAP. Të dhënat garantohen për studentët në mënyrë fizike te rregjistrat dhe virtuale nëpërmjet zonës së studentit në portalin Pitagora. Megjithatë, nuk ka një sistem elektronik dedikuar për stafin akademik dhe administrativ <i>(Ref. RVB, fq. 38-39; Takimet me Zyrën e Burimeve Njërezore dhe me Sekretarinë Mësimore).</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe	Platformat Office 365 dhe Microsoft Teams jepet në përdorim që mundëson komunikimin interaktiv dhe transmetimin e informacionit ndërmjet studentëve dhe stafit akademik, nga lektori te studenti në konfidencialitet të plotë. Njëherazi, nëpërmjet emaileve zyrtare të AU, bëhet i mundur konsultimi dhe

shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	komunikimi ndërmjet studentëve dhe personelit akademik ose personelit administrativ (Ref. RVB, fq. 39).			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Office 365 dhe Microsoft Teams ofrojnë platforma për komunikim brenda institucionit. Megjithatë, mungesa e një sistemi elektronik të dedikuar për stafin akademik dhe administrativ nuk i mundëson institucionin dhe drejtuesit e tij nga të pasurit monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale (Ref. RVB, fq. 39).			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Faqja web të institucionit www.albanianuniversity.edu.al përmban informacione mbi personalin akademik, programet e studimit, aktivitete, njoftime në gjuhën shqipe, angleze dhe atë italiane. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, janë të përditësuara në faqen e internet të AU (Ref. RVB, fq. 39; Faqja zyrtare e AU: https://albanianuniversity.edu.al/).			
Konkluzione	GVJ, bazuar në gjetjet e saj në seksionin përshkrues, pranon se AU ka zbatuar një sistem të brendshëm të menaxhimit të krijuar për të mbështetur administrimin, rrjedhën e informacionit dhe monitorimin e aktiviteteve akademike, financiare dhe administrative në lidhje me programin e studimit MShAP. Ky sistem fizik dhe i centralizuar mundëson menaxhimin e plotë të të dhënave të lidhura me programin, lehtëson operacionet efikase dhe siguron përputhjen me standardet institucionale dhe ligjore. Megjithatë, shtimi i një sistemi digjital të menaxhimit të personelit do t'i mundësonte institucionit të pasurit monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	AU si institucion që financohet nga pagesat e tarifave të shkollimit nga studentët si dhe nga të ardhurat e tjera të shoqërisë që administron institucionin, harton rregullisht një raport financiar për kostot e programeve të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të tyre. Planet financiare hartohen nga Administratori i Përgjithshëm i institucionit, i përcillen Rektoratit dhe Senatit Akademik, e pastaj i kalohen për miratim Bordit të Administrimit, në përputhshmëri të plotë me ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi <i>(Ref. RVB, fq. 39-40; Takimi me Administratorin i Përgjithshëm).</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të	Plani i financimit të programit të studimit MShAP përfshihet në planin financiar të institucionit. Plani mban elementet dhe zërat specifik për financimin, si: orët mësimore të realizuara nga personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, aktivitete shkencore e shpenzimet e ndryshme operative. Megjithatë, planet financiare nuk janë të ndara sipas departamenteve apo programeve të studimit <i>(Ref. RVB, fq. 40).</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe	Auditimi financiar si një procedurë e përvitshme kryhet si nga Zyra e Auditit të Brendshëm, edhe nga audit i jashtëm nga një kontabël i regjistruar <i>(Ref. RVB, fq. 40-41).</i>

efektivitetin financiar të tij.				
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Institucioni disponon raportet financiare për çdo vit. Megjithatë, institucioni nuk raporton në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës (Ref. RVB, fq. 41).			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale financimit të programeve të studimeve.	Të dhënat financiare dëshmojnë se AU siguron qëndrueshmëri dhe kapacitete financiare për zhvillimin e programit të studimit. Në rastet e riskut të reduktimit të numrit të studentëve, dhe për rrjedhojë edhe i të ardhurave financiare të lidhura me studentët në të ardhmen, institucioni ka synuar diversifikimin e financimeve duke aplikuar dhe fituar disa projekte kërkimore dhe bashkëpunime me universitete evropiane (Ref. RVB, fq. 41).			
Konkluzione	GVJ, duke marrë parasysh statusin e AU si një institucion i financuar nga nga pagesat e tarifave të shkollimit nga studentët si dhe nga të ardhurat e tjera të shoqërisë që administrojnë, konstaton se AU siguron financimin dhe burimet e duhura financiare për zbatimin e procesit mësimor dhe kërkimor, vazhdimësinë e programit të studimit dhe mbështetjen e gjithanshme të studentëve. Ky angazhim mbetet i patundur edhe pse numri i studentëve të regjistruar në programin MShAP ka pësuar rënie të ndjeshme. Aftësia e AU për të mbajtur mbështetjen financiare pavarësisht luhatjeve të regjistrimit pasqyron një angazhim për stabilitet në ofertat e programit, duke siguruar që studentët dhe pedagogët të vazhdojnë të përfitojnë nga burimet thelbësore dhe mbështetja institucionale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	AU harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë çdo fazë të rrugëtimit akademik të studentëve, nga hyrja deri në diplomim, duke siguruar përputhjen me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret institucionale. GVJ vlerëson se politikat dhe procedurat që shoqërojnë procesin nga hyrja në dalje të studentëve, përgjatë gjithë ciklit të studimeve, mbështeten në legjislacionin në fuqi, Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në VKM Nr.436, datë 03.06.2020 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e ciklit të dytë”. Kjo qasje gjithëpërfshirëse mbështet një përvojë akademike të strukturuar, ndërkohë që përputhet me standardet e cilësisë. Kriteret e pranimit përcaktohen në bazë të objektivave të programit dhe përputhen me standardet kombëtare arsimore, duke siguruar procese të drejta dhe transparente përzgjedhjeje. Politikat e pranimit ofrojnë informacion të detajuar mbi kërkesat e hyrjes, procedurat e aplikimit dhe afatet, duke mbështetur studentët e ardhshëm gjatë gjithë procesit të aplikimit. Politikat rishikohen rregullisht në përputhje me legjislacionin kombëtar, kërkesat e akreditimit dhe standardet institucionale të cilësisë <i>(Ref. RVB, fq. 42; Evidencë 1.2.a. - Rregullore e AU; Vizita në AU dhe bisedat me studentët dhe stafin akademik, administrativ e drejtuesit).</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të	Dispozitat e veçanta sigurojnë që të gjithë studentët e kualifikuar, përfshirë grupet e nënpërfaqësuar, të kenë akses të barabartë në pranim dhe në dalje, në përputhje me diversitetin institucional dhe qëllimet e përfshirjes. Kriteret dhe procedurat hartohen nëpërmjet

njëta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	një procesi transparent dhe përzgjedhja e aplikantëve bëhet duke respektuar kuotat e pranimit, përfshirë këtu edhe vlerësimi i studentëve që po i afrohen diplomimit <i>(Ref. RVB, fq. 42; Evidencë 1.2.a. - Rregullore e AU).</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve hartohen nga FSHS përpara nisjes së çdo viti akademik. Referuar dokumenteve si Statuti dhe Rregullore e AU, si dhe vendimeve apo udhëzimeve në lidhje me kuotat, tarifat e studimit, kriteret e pranimeve të studentëve, si dhe nga takimet në AU, GVJ gjykon se ato hartohen në bashkëpunim mes FSHS dhe strukturave të ngritura në zbatim të kuadrit rregullator <i>(Ref. RVB, fq. 42; Evidencë 1.1.a. - Statuti AU; Evidencë 1.2.a. - Rregullore e AU; Evidencë 1.7. - Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Administrim Publik me profile; Takimi me Dekanin e FSHS).</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	AU siguron që kriteret dhe procedurat që lidhen me pranimin e studentëve, përparimin, transferimet, njohjen e mësimi të mëparshëm, vlerësimin dhe diplomimin të jenë transparente, të drejtpërdrejta dhe të aksesueshme nga publiku. Të gjitha kërkesat e pranimit, kriteret e përzgjedhjes dhe proceset e aplikimit janë të përshkruara qartë në faqen zyrtare të institucionit dhe në materialet e shtypura, duke siguruar që studentët e ardhshëm të kenë akses të lehtë në informacione gjithëpërfshirëse. Sekretariatë dhe zyrat këshilluese të AU ofrojnë udhëzime shtesë dhe u përgjigjet pyetjeve, duke ofruar ndihmë të personalizuar për të ndihmuar aplikantët dhe studentëve të lundrojnë në procesin e përparimit përgjatë kursit të studimit. Një manual është i disponueshëm për studentët, duke detajuar kërkesat për përparimin e kursit, parakushtet dhe kërkesat për kredi, duke i ndihmuar studentët të kuptojnë rrugën e tyre drejt diplomimit. Politikat për transferimin e krediteve nga institucione të tjera ose njohjen e studimeve të mëparshme janë të detajuara në faqen e internetit dhe në manualin e studentëve, duke përshkruar përshtatshmërinë, dokumentacionin e kërkuar dhe proceset e vlerësimit. Institucioni publikon të gjitha kërkesat për diplomim, duke përfshirë orët e kreditimit, vlerësimet përfundimtare dhe çdo projekt themelor, dhe komunikon këta përmes kanaleve të shumta, të tilla si rikujtuesit me email dhe faqen e internetit

	(Ref. RVB, fq. 42-43; Evidencë 1.7. - Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Administrim Publik me profile; Evidencë 2.4. - Rregullore e Rregjistrimit dhe Trasferimeve; Evidencë 3.8. - Rregullore e Diplomimit; Evidencë 3.11. - Shembull procedurë diplomimi; Biseda me studentët; https://albanianuniversity.edu.al/).
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Përpara fillimit të çdo viti akademik, AU ndërmerr disa masa për të informuar publikun dhe studentët e ardhshëm për kërkesat dhe kriteret e përgjithshme dhe specifike për programin e studimit MShAP. AU fillon informimin e maturantëve gjatë Ditëve të Informimit të organizuara nga MAS. AU ofron një faqe online të përditësuar, të dedikuar për programet e studimit, duke u lejuar studentëve të ardhshëm të kenë akses në informacione të duhura. AU njëkohësisht organizon sesione informacioni, ditë të hapura dhe takime pyetjesh dhe përgjigjesh ku koordinatorët e programeve, stafi akademik dhe administrativ prezantojnë detajet e programeve dhe u përgjigjen pyetjeve. Kërkesat e programit dhe afatet e aplikimit shpërndahen në kanalet institucionale të mediave sociale, duke arritur një audiencë më të gjerë dhe duke rritur ndërgjegjësimin (Ref. RVB, fq. 43; Evidencë 5.1. - Info days për maturantët; Evidencë 5.5. - Vendim për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit; Evidencë 5.6. - Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit; Evidencë 5.7. - Udhëzues Orientues për Maturantët; https://albanianuniversity.edu.al/).
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	AU ka hartuar dhe publikuar kriteret për kategori të veçanta. Konkretisht, studentët që janë jetim përfitojnë nga lehtësimet në regjistrim. Për studentët me aftësi të veçanta në godinat e AU-së është vënë në dispozicion infrastruktura e nevojshme për të lehtësuar lëvizjen e tyre (Ref. RVB, fq. 43; Evidencë 5.5. - Vendim për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit; Evidencë 5.6. - Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit).
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Përpara çdo viti akademik, AU harton dhe publikon, në përputhje me aktet ligjore përkatëse kriteret dhe procedurën për pranimin e studentëve të huaj, si dhe kandidatët e trojeve. Kriteret përzgjedhëse janë të njëjtat me aplikantët brenda vendit, por kuotat janë të dedikuara për këto kategori dhe aplikimet bëhen sipas udhëzimeve të MAS

	(Ref. RVB, fq. 43; Evidencë 5.5. - Vendim për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit; Evidencë 5.6. - Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit).			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	AU ka politika mbështetëse për studentët e kategorive sociale të veçanta siç janë jetimët, studentë të komunitetit Rom, studentë me aftësi të kufizuara. Ata përfitojnë bursa për studim në ciklin e dytë master shkencor (Ref. RVB, fq. 43).			
Konkluzione	GVJ konstaton se AU ka vendosur politika dhe procedura gjithëpërfshirëse që rregullojnë pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimet, njohjen e mësimit paraprak, vlerësimin e njohurive dhe diplomimin për programin MShAP. AU zbaton politika që ofrojnë ulje të tarifës për studentët financiarisht të pafavorizuar. Këto politika janë lehtësisht të aksesueshme për publikun përmes faqes zyrtare të institucionit dhe komunikohen rregullisht, duke siguruar transparencë dhe lehtësi aksesimi për studentët e ardhshëm dhe aktualë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	AU siguron që studentët të kenë akses në informacion të plotë, të qartë dhe të detajuar në lidhje me kriteret dhe procedurat për përparimin akademik dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin. Institucioni publikon një Manual i cili detajon të gjitha kërkesat për përparimin akademik, duke përfshirë pragjet minimale të notave, kërkesat për kredite dhe parakushtet për avancim në vitin tjetër. GVJ nga biseda me studentët konfirmon se AU u siguron studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi kriteret e procedurat e përparimit akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, të cilat specifikohen në dokumentet e brendshme të AU. Staf i akademik takohet me studentët individualisht ose në grupe çdo semestër për të shqyrtuar përparimin, për të diskutuar kërkesat dhe për të adresuar

	pyetje në lidhje me kalimin në vitin e ardhshëm. Çdo përditësim i politikave ose kriterëve të përparimit komunikohet në faqen e internetit dhe përmes emailit <i>(Ref. RVB, fq. 44; Evidencë 1.2.a. - Rregullore e AU; Evidencë 5.11. – Manuali i Studentit).</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Kriteret dhe procedurat për njohjen e studimeve dhe kualifikimeve të mëparshme, të plota ose të pjesshme, janë të përcaktuara në Rregulloren e AU sipas sistemit të krediteve. GVJ nga bisedat me studentët konfirmon se ata janë të informuar në lidhje me kriteret që për transferimin e studimeve. Kriteret janë të kuptueshme e të aksesueshme për studentë dhe të gjithë të interesuarit. Zyra e Transferimeve dhe Ekuivalentimeve të Studimeve njeh studentët e interesuar me procedurat përkatëse për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve <i>(Ref. RVB, fq. 44; Evidencë 1.2.a. - Rregullore e AU; Evidencë 2.4. - Rregullore e Regjistrimit dhe Transferimeve; Takimi me Studentët).</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Gjatë javës së parë të vitit akademik, institucioni organizon ditët orientuese, gjatë të cilave, stafi akademik, stafi administrativ dhe Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët dhe Këshilli Studentor informojnë studentët mbi procedurat që ndjekin mbarëvajtjen e studimeve të tyre. Gjatë gjithë semestrit, stafi akademik jep komente për detyrat e përfunduara, duke u dhënë studentëve njohuri se si vlerësohen aftësitë e tyre dhe fushat ku mund të nevojitet përmirësim. Faqja e internetit e AU përfshin dokumente të aksesueshme publikisht që përshkruajnë politikat e vlerësimit, shkallët e vlerësimit, standardet e integritetit akademik dhe procedurat për rivlerësim ose apelime. Manuali i Studentit përshkruan politikat e vlerësimit, duke përfshirë kërkesat për kalim/dështim, peshimin e vlerësimeve dhe protokollet për lloje të ndryshme vlerësimi. GVJ bazuar në bisedat me stafin akademik, studentët dhe në kuadrin rregullator të AU konfirmon se kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive ju bëhen me dije studentëve nga lektorët e lëndëve respektive që në orën e parë mësimore; po ashtu ato janë të shpallura në planprogramet, si dhe në faqen online të AU <i>(Ref. RVB, fq. 44; Evidencë 1.2.a. - Rregullore e AU; Evidencë 2.2. - Syllabuset e lëndëve Master Shkencor Politika Publike dhe BE; Evidencë 2.2. - Syllabuset e lëndëve Master Shkencor Politika Publike dhe Qeverisje; Evidencë 5.11. – Manuali i Studentit; Takimet me stafin akademik dhe studentët).</i>

Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	AU ofron një Manual të dedikuar tezës dhe diplomimit, duke detajuar kërkesat, afatet kohore, rubrikat e notave dhe proceset e paraqitjes. Gjithashtu, DSHJPA organizon seminare për përgatitjen e tezës ose sesione orientuese, veçanërisht për studentët e vitit të fundit, për të shpjeguar kriteret, afatet dhe pritshmëritë në lidhje me kërkimin, shkrimin dhe dorëzimin. Studentët takohen me stafin akademik të cilët sqarojnë kërkesat e tezës, ofrojnë udhëzime kërkimore dhe u përgjigjen pyetjeve specifike që lidhen me procesin e tezës. Në klasat e vitit të fundit ose në kurset kryesore, stafi akademik diskuton pritshmëritë e tezës dhe kërkesat e diplomimit, duke u siguruar që studentët të kenë një kuptim të qartë të standardeve akademike dhe metodave të vlerësimit. Çdo studenti i caktohet një këshilltar i tezës, i cili shërben si pikë kryesore kontakti për udhëzime për kërkimin, shkrimin dhe përputhshmërinë me standardet e tezës. Këshilltarët mbajnë takime të rregullta progresi me studentët për të rishikuar punën e tyre, për të dhënë komente dhe për të siguruar që ata janë në rrugën e duhur për të përmbushur kërkesat e tezës dhe të diplomimit <i>(Ref. RVB, fq. 44; Evidencë 1.7. - Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Administrim Publik me profile; Evidencë 3.8. - Rregullore e Diplomimit; Evidencë 3.9. - Manuali për punimin e temave të diplomës; Evidencë 3.10. - Shkresa për ngritjen e komisionit të diplomimit; Evidencë 3.11. - Shembull procedurë diplomimi; Bisedat me studentët dhe me stafin akademik).</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	GVJ, nga bisedat me stafin dhe studentët, del qartë që në fillim të çdo viti akademik ata ndërmarrin një sërë veprimtarish informuese në formën e takimeve të hapura dhe te Ditëve të Informimit të organizuara nga MAS për tërheqjen e kandidatëve potencialë për studentë të masterit. Faqja online e AU dhe broshurat informative ofrojnë informacione mbi programin e studimit, kriteret e pranimit dhe mënyrën e aplikimit <i>(Ref. RVB, fq. 44-45; Evidencë 5.7. - Udhëzues Orientues për Maturantët; https://albanianuniversity.edu.al).</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se AU ofron në mënyrë efektive informacion gjithëpërfshirës dhe të detajuar për studentët në lidhje me programin e studimit në fillim të çdo viti akademik. Kjo përfshin udhëzime të plota për përparimin akademik, njohjen e mësimit paraprak, vlerësimin e njohurive, rregulloret e provimeve, strukturën e tezës së diplomës dhe kërkesat e diplomimit për programin Master.

	Institucioni e shpërndan këtë informacion nëpërmjet takimeve të organizuara nga stafi dhe drejtuesit e kurseve, dhe duke ofruar burime të aksesueshme si broshurat dhe faqen e internetit të AU. Këto kanale jo vetëm që informojnë studentët aktualë, por gjithashtu shërbejnë për të tërhequr kandidatët e mundshëm duke ofruar një pasqyrë të qartë në strukturën dhe kërkesat e programit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	IAL publikon një Manual për studentët që përshkruan strukturën e programit, duke përfshirë lëndët e kërkuara, opsionet zgjedhore, specializimet dhe totalin e krediteve të kërkuara për diplomim. Manuali përfshin gjithashtu informacion mbi praktikën, mundësitë e kërkimit dhe komponentët e tjerë të të mësuarit eksperimental, si dhe kohëzgjatjen e programit. Në fillim të semestrit akademik, DSHJPA mban seanca orientuese për studentët e rinj. Këto sesione ofrojnë një hyrje në programin e studimit MShAP, duke shpjeguar strukturën e kurrikulës, politikat kryesore, metodat e vlerësimit dhe burimet e disponueshme. Anëtarët e stafit akademik dhe koordinatori i programit marrin pjesë, duke u dhënë studentëve një mundësi për të bërë pyetje. Përveç kësaj, AU ka një seksion të dedikuar në faqen e saj të internetit për programet e ofruara nga DSHJPA, ku studentët mund të kenë informacion të detajuar në lidhje me kurrikulën, kohëzgjatjen, përshkrimet e kurseve dhe rezultatet e të nxënës. Universiteti përdor gjithashtu portal online Pitagora ku studentët mund të shikojnë përparimin e tyre të diplomës, të regjistruhen në klasa dhe të gjurmojnë momentet e tyre akademike. Për çdo lëndë brenda programit, instruktorët ofrojnë një planprogram që specifikon objektivat e kursit, temat e mbuluara, metodat e vlerësimit dhe ngarkesën e pritshme të punës. Kjo i ndihmon studentët të kuptojnë se si çdo lëndë përshtatet në strukturën më të gjerë të programit. DSHJPA shpesh komunikon drejtpërdrejt me studentët përmes emaileve ose njoftimeve. Ky komunikim mund të përfshijë kujtime për afate të rëndësishme, ndryshime të kurrikulës dhe përditësime të tjera për t'i mbajtur studentët të informuar. Statuti dhe Rregullorja e AU, Manuali i Studentëve, dhe planprogramet janë dokumente me të

	cilat studentët informohen në mënyrë të hollësishme për të gjithë komponentët e programit të studimit (Ref. RVB, fq. 45; Evidencë 1.1.a. - Statuti AU; Evidencë 1.2.a. - Rregullore e AU; Evidencë 1.7. - Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në Administrim Publik me profile; Evidencë 2.2. - Syllabuset e lëndëve Master Shkencor Politika Publike dhe BE; Evidencë 2.2. - Syllabuset e lëndëve Master Shkencor Politika Publike dhe Qeverisje; Evidencë 5.11. – Manuali i Studentit; https://albanianuniversity.edu.al/; Bisedat me stafin akademik dhe me studentët).
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Stafi akademik ofron planprograme në fillim të çdo kursi, i cili përshkruan objektivat e kursit, temat javore, kriteret e notave, rezultatet e të nxëniet dhe pritshmëritë për pjesëmarrjen e studentëve. Gjithashtu, në fillim të çdo viti akademik studentët pajisen me një dosje, e cila përmban informacione mbi planin kalendarik të programit të studimit, orarin mësimor, dhe planprogramet e lëndëve që do të zhvillohen. Universiteti i ka kushtuar një seksion specifik në websajtin e tij ku përshkrimet e kurseve, strukturat e moduleve, informacioni i kreditit dhe udhëzimet e përgjithshme të kurseve janë të aksesueshme. Në fillim të një kursi ose moduli, stafi akademik shpesh mbajnë sesione orientuese për t'i njohur studentët me përmbajtjen, strukturën dhe metodat e vlerësimit. Këto sesione janë gjithashtu një mundësi për studentët që të bëjnë pyetje dhe të qartësojnë pritshmëritë, duke i ndihmuar ata të fillojnë kursin me një kuptim të qartë të kërkesave. Anëtarët e stafit akademik dhe ndihmësit e tyre janë burime të vlefshme për sqarimin e përmbajtjes së lëndës, pritshmërive dhe udhëzimeve. AU publikon Manual studentësh që përvijojnë strukturën e programit, duke përfshirë detaje për kurse specifike, module brenda programit. DSHJPA dhe anëtarët e stafit akademik përdorin shpesh email ose njoftime në Microsoft Teams për të komunikuar përditësime ose rikujtues rreth detyrave, afateve dhe informacione të tjera thelbësore që lidhen me kurset. Studentët i prezantuan GVJ gjatë vizitës në AU, se sa i takon kurrikulës dhe lëndëve të programit të studimit, përmbajtjes së syllabuseve dhe organizimit të veprimtarisë formuese se ata janë të njoftuar që në fillim të studimeve. Njësia bazë DSHJPA si përgjegjëse për programin e studimit i ka bërë transparente të dhënat në faqen online me shpalljen e Planit Mësimor të MShAP (Ref. RVB, fq. 45; Evidencë 2.2. - Syllabuset e lëndëve Master Shkencor Politika Publike dhe BE; Evidencë 2.2. - Syllabuset e lëndëve Master Shkencor Politika Publike dhe Qeverisje; Evidencë

	5.11. – Manuali i Studentit; https://albanianuniversity.edu.al/ ; Bisedat me stafin akademik dhe me studentët).
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	AU ka një Zyrë të dedikuar për shërbimet e Karrierës dhe Alumnit si dhe Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët që ofrojnë informacion mbi hapjet e punës, praktikën dhe vendosjet në industri. Ata shpesh publikojnë njoftime ku studentët mund të informohen për mundësitë e punësimit në fushat e tyre të studimit, të lidhen me punëdhënësit dhe të aplikojnë drejtpërdrejt për vende vakante. AU organizon rregullisht panairë karriere me punëdhënësit ku kompanitë dhe organizatat rekrutojnë studentë për praktika, punë me kohë të pjesshme ose pozicione me kohë të plotë. Këshillimi individual për karrierë është i disponueshëm për studentët që kërkojnë udhëzime të personalizuar. Programi i studimit MShAP ofron programe praktike, ku studentët fitojnë përvojë pune praktike si pjesë e kurrikulës së tyre akademike. Zyra e Karrierës dhe Alumnit gjithashtu ndihmon studentët në gjetjen dhe sigurimin e praktikave. AU bashkëpunon me organizatat publike dhe jopublike, si dhe me kompani për të ofruar mundësi rekrutimi. Punëdhënësit mund të mbajnë sesione informacioni, të kryejnë intervista ose të japin prezantime rreth roleve të punës dhe mundësive të karrierës. Nga takimi i GVJ me specialistin e Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, vlerësojmë se kjo strukturë përgjegjëse informon dhe këshillon studentët për mundësitë e praktikave mësimore, rritjen e kapaciteteve profesionale dhe mbi mundësitë të punësimit. AU e ka formalizuar këtë veprimtari në Rregulloren e Zyrës së Karrierës dhe Alumnit (Ref. RVB, fq. 45; Evidencë 5.2. - Rregullore e Zyrës së Karrierës dhe Alumnit; Evidencë 5.4. - Panairi Work & Study; Evidencë 5.8. Leksion i hapur "Si të punësohesh"; Evidencë 5.9. - Leksion i hapur për nxitjen e studentëve për punësim; Evidencë 5.12. - Udhëzues për Zhvillimin e Karrierës; Takimi me Zyrën e Karrierës dhe Alumnit).
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Stafi i DSHJPA i dha GVJ-së informacion të plotë dhe aktual mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor. GVJ vizitoi gjithashtu godinën, të cilat ofrojnë mbështetjen e duhur logjistike për programin MShAP, një fushë që nuk kërkon infrastrukturë komplekse. Studentët mund të kenë lehtësisht informacion në lidhje me këto burime përmes DSHJPA dhe kanaleve të ndryshme të komunikimit online nga AU, siç konfirmohet në bisedat me studentët (Ref. RVB, fq. 45-46; Evidencë 5.10. - Axhenda e javës orientuese; Evidencë 5.11. - Manuali i Studentit; Takimet me stafin akademik dhe me studentët).

Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	AU ka portal studentor Pitagora të dedikuar që ofron akses të centralizuar në informacionin kyç mbi programin e studimit. Nëpërmjet faqes online të AU, studentët mund të shikojnë strukturat e programit, përshkrimet e lëndëve, parakushtet, kreditet dhe kërkesat e diplomimit. AU publikon Manual që ofron përshkrime të hollësishme të secilit program, duke përfshirë objektivat, kërkesat e kurrikulës, opsionet zgjedhore dhe çdo specializim të disponueshëm. Nëpërmjet sistemit Microsoft Teams, studentët mund të aksesojnë kalendarin akademik dhe oraret e tyre të kurseve <i>(Ref. RVB, fq. 46; Evidencë 5.11. - Manuali i Studentit; Evidencë 3.7. - Manual i përdorimit të Pitagorës; Evidencë 6.1. - Klasa Teams; Evidencë 6.2. - Manuali i përdorimit të platformës Teams).</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se AU u ofron studentëve informacion për të gjitha aspektet e programit të tyre të studimit. Kjo përfshin objektivat arsimore, strukturën, organizimin, përmbajtjen, rezultatet e pritura të të nxënës dhe mundësitë e mundshme të punësimit që lidhen me programin. Nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit dhe i mbështetur nga platformat përkatëse si Pitagora dhe Microsoft Teams, AU siguron që studentët të kenë akses të lehtë në informacionin aktual.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	AU mban statistika vjetore për numrin e studentëve dhe të diplomuarve brenda programit të studimit duke përdorur praktika të mbledhjes, menaxhimit dhe raportimit të të dhënave, të menaxhuara zakonisht përmes sistemeve të tyre të brendshme të informacionit. AU përdor sistem të centralizuar të informacionit të studentëve, si Pitagora, për të mbledhur, ruajtur dhe përditësuar të dhënat për studentët e regjistruar. Ky sistem gjurmon automatikisht të dhënat e studentëve nëpër parametra të ndryshëm, duke përfshirë statusin e regjistrimit, përparimin e programit dhe diplomimin. Çdo vit, të dhënat për studentët e sapo regjistruar, studentët që vazhdojnë dhe të diplomuarit përditësohen në sistem. Sekretaria Mësimore dhe DSHJPA janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e mbledhjes së të dhënave dhe verifikimin e saktësisë. Ata përpilojnë raporte vjetore mbi

demografinë e studentëve, tendencat e regjistrimit dhe statistikën e diplomimit, të cilat përdoren për planifikimin institucional dhe vlerësimin e programit. Për të siguruar saktësinë, institucionet kryejnë auditime të rregullta të të dhënave të studentëve. Kjo mund të përfshijë kontrollimin e të dhënave për të mbajtur informacion të qëndrueshëm dhe të përditësuar, identifikimin e tendencave dhe adresimin e çdo mospërputhjeje në numrin e studentëve të regjistrimit ose të diplomimit. Çdo vit, AU përpilon raporte që përmbledhin statistikën e regjistrimit, duke përfshirë numrin e studentëve sipas programit, normat e diplomimit dhe metrika të tjera kryesore. Këto raporte shpesh ndahen me udhëheqjen e universitetit, organet e akreditimit dhe palët përkatëse të interesit. AU, si institucion i arsimit të lartë, respekton detyrimin për të raportuar periodikisht në MAS të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve. Numri i studentëve në programin e studimit MSHAP nga viti akademik 2019-2020 deri në vitin 2023-2024 ka qenë 82 dhe numri i diplomuarve nga viti akademik 2019-2020 deri në vitin 2022-2023 ka qenë 49

Numri i studentëve Masteri Shkencave në: “Administrim Publik” me profil a. Politika Publike dhe BE,

Viti akademik	Studentë gjithsej
2022-2023	3
2023-2024	0

Numri i studentëve Masteri Shkencave në: “Administrim Publik” me profil b. Politika Publike dhe Qeverisje

Viti akademik	Studentë gjithsej
2022-2023	16
2023-2024	7

(Ref. RVB, fq. 46; RVB Aneks - Tabelat Përmbledhëse - Tabela 21 dhe Tabela 23; Takimi me Sekretarinë Mësimore).

Kriteri 2. Institucioni disponon statistika

AU mban të dhëna dhe statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në çdo program, përqindjet e braktisjes dhe numri i

vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	studentëve që nuk përfundojnë programin brenda kornizës kohore standarde. Të dhënat përditësohen me tërheqjet apo largimet para përfundimit të programit, deri tek diplomimet apo ata që nuk i kanë përfunduar ende studimet me sukses atë vit akademik <table><tr><th>Viti akademik</th><th>Studentë të regjistruar</th><th>Studente të transferuar</th><th>Studentë gjithsej</th></tr><tr><td>2022-2023</td><td>19</td><td></td><td>19</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>7</td><td></td><td>7</td></tr></table>	Viti akademik	Studentë të regjistruar	Studente të transferuar	Studentë gjithsej	2022-2023	19		19	2023-2024	7		7
Viti akademik	Studentë të regjistruar	Studente të transferuar	Studentë gjithsej										
2022-2023	19		19										
2023-2024	7		7										
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sekretaria Mësimore ruan Regjistrat e të gjithë aktivitetit. Regjistrat lejojnë administratorët të monitorojnë të dhënat, dhe çfarë ndryshimesh janë bërë. GVJ provoi gjatë vizitës në AU se të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen nga Sekretaria Mësimore. Të dhënat te Regjistrat si dhe te sistemi të informacionit Pitagora mbrohen për të parandaluar aksesin e paautorizuar. Qasja në të dhënat e studentëve kontrollohet rreptësisht përmes lejeve të bazuara në role, duke lejuar vetëm personelin e autorizuar, siç janë zyrtarët e Sekretarisë Mësimore, të shikojnë ose menaxhojnë me informacion të ndjeshëm që ato menaxhojnë. Kjo siguron që vetëm ata me arsye legjitime të kenë akses në të dhëna të detajuara (Ref. RVB, fq. 46; Takimi me Sekretarinë Mësimore).												
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.),	Rektorati, Zyra e Kontrollit dhe Auditit të Brendshëm dhe Sekretaria Mësimore ushtron kontroll mbi gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. Me përfundimin e sezonit të provimeve apo riprovimeve dhe depozitimit të procesverbaleve me notën përfundimtare nga titullari i lëndës, sekretaria mësimore i pasqyron notat si në rregjistra ashtu edhe në bazën elektronike të të dhënave Pitagora												

vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	(Ref. RVB, fq. 47; Evidencë 1.2.a. - Rregullore e AU; Evidencë 3.12. - Rregullore e Sekretarisë Mësimore; Takimi me Sekretarinë Mësimore).			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre reguesve.	DSHJPA harton raporte periodike analitike mbi profilin dhe cilësinë e studentëve që hyjnë dhe dalin, si dhe cilësinë e rezultateve të punësimit të tyre, duke përdorur mbledhjen sistematike të të dhënave, analizën dhe proceset e planifikimit strategjik. GVJ nga biseda me DSHJPA vlerëson se ata e kishin në vëmendje reduktimin e numrit të studentëve në programin e studimit MShAP. GVJ arriti në përfundimin se stafi dhe menaxhmenti i departamentit ishin të vetëdijshëm për rënien e regjistrimit të studentëve dhe implikimet e saj të mundshme për programin e studimit. Të dhënat e punësimit mblidhen nga anketat e dërguara të sapodiplomuarve dhe të dhënat nga shërbimet e karrierës që gjurmojnë statusin e punësimit. Zyra e Karrierës dhe Alumnit dhe DSHJPA angazhohen për të ndihmuar studentët që të bëjnë lidhjen më të mirë mes përvojës së tyre aktuale akademike dhe karrierës në punë (Ref. RVB, fq. 47; RVB Aneks - Tabelat Përmbledhëse - Tabela 21 dhe Tabela 23; Evidencë 1.9. - Raport Vjetor i Departamentit të Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative; Takimi me stafin akademik).			
Konkluzione	AU mban statistika vjetore për numrin e studentëve dhe të diplomuarve brenda programit të studimit duke përdorur praktika të mbledhjes, menaxhimit dhe raportimit të të dhënave, të menaxhuara zakonisht përmes sistemeve të tyre të brendshme të informacionit. GVJ vlerëson se AU, si institucion i arsimit të lartë, përmbush detyrimin e saj për të raportuar periodikisht të dhëna të detajuara në MAS. Kjo përfshin informacion mbi numrin dhe profilin e studentëve në çdo program studimi, dhe gjurmimin e tyre nga pranimi deri në diplomim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	AU siguron përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse dhe këshillimore duke vendosur role dhe procese formale, të përcaktuara nga kornizat e veta ligjore dhe rregullatore. Sipas rregulloreve institucionale, studentët shpesh zgjidhen ose emërohen për të marrë pjesë në organet kryesore drejtuese, si Senati Akademik i Universitetit, Këshilli Studentor, Komisioni për Kurikulat dhe Mësimin, Komisioni për Vlerësimin Institucional, si dhe te Komisioni për Kërkimin Shkencor dhe Botimin. Këta përfaqësues kanë të drejta votimi ose role këshilluese, duke siguruar që zëri i studentëve të përfshihet në vendimet që ndikojnë në politikat akademike dhe administrative. Kontributi i tyre kërkohet në përmbajtjen e programit, metodat e mësimdhënies dhe proceset e vlerësimit, duke siguruar që kurrikula të mbetet relevante dhe t'u përgjigjet nevojave të studentëve. Nga biseda e GVJ me studentët del qartë se ata janë të familjarizuar dhe të angazhuar me çfarë aktivitete zhvillohen në DSHJPA ose në FSHS. Pjesëmarrja e studentëve në vendimmarrjen e DSHJPA ose në FSHS realizohet kur ata ftohen në mbledhje ku ka për tu marrë ndonjë vendim që i ndikon ata. Në nivel institucioni, Statuti i AU specifikon procedurat e përfshirjes së studentëve në vendimarrje <i>(Ref. RVB, fq. 47-48; Evidencë 1.1.a. - Statuti AU; Takimi me studentët).</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ nga bisedat me studentët konfirmoi se në fund të çdo semestri ata vlerësonin procesin mësimor të programit MShAP. Rëndësia e angazhimit real të studentëve në vlerësimin e procesit akademik vlerësohej pozitivisht nga stafi akademik dhe drejtuesit që reflektonin rezultatet e anketimit të tyre <i>(Ref. RVB, fq. 47-48; Takimi me studentët).</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit	Studentët marrin pjesë në vlerësime dhe rishikime periodike të politikave akademike, si kriteret e notave, dhe metodat e vlerësimit. Duke kontribuar me njohuri nga këndvështrimi i studentëve, ato ndihmojnë në formimin e politikave që ndikojnë në mjedisin e tyre të të mësuarit. Institucioni shpesh përfshin përfaqësues të studentëve në organet e sigurimit të cilësisë, p.sh. te grupet i vlerësimit të brendshëm, duke siguruar që perspektivat

mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	e studentëve të merren parasysh në vlerësimin e programit, akreditimin dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Këto komitete përdorin komentet e studentëve nga anketat, fokus grupet ose përfaqësimin e drejtpërdrejtë për të këshilluar administratën e universitetit për përmirësime. Komentet e mbledhura paraqiten në sesionet vendimmarrëse. GVJ gjykon se fakti i një numri të limituar studentësh, ka qenë një nxitje më shumë për t'i përfshirë ata në diskutimet për përmirësimin e programit të studimit që organizohen nga DSHJA, FSHS ose nga njësitë e sigurimit të cilësisë. Opinioni i studentëve është reflektuar në përshtatjen e mësimdhënies, orareve, shpërndarjes së provimeve, ndryshimet për planprogramet e lëndëve, etj <i>(Ref. RVB, fq. 48; Evidencë 1.1.a. – Statuti i AU; Takimi me studentët).</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	AU ofron mundësi të strukturuar për studentët për të dhënë komente mbi barazinë dhe ndershmërinë e praktikave të vlerësimit dhe notave , dhe ajo ka formuar mekanizma formalë që studentët të apelojnë ose të kërkojnë një rishikim të rezultateve të tyre. Procesi i vlerësimit dhe kontrollit të dijeve ju behet i njohur studentëve nga pedagogu që në orën e parë të saj. Në fund të çdo kursi, universiteti kryen vlerësime anonime të lëndëve ku studentët mund të japin komente mbi procesin e mësimdhënies. Përfaqësuesit e studentëve shpesh ulen në forumet akademike dhe administrative përgjegjëse për mbikëqyrjen e politikave të vlerësimit. Nëpërmjet këtyre roleve, studentët mund të paraqesin shqetësime për drejtësinë e vlerësimeve dhe të marrin pjesë në diskutime se si të përmirësohen ose përshtaten praktikat e vlerësimit. Studentët kanë edhe kanale të tilla si orët e hapura të zyrës, ku ata mund të komunikojnë drejtpërdrejt me anëtarët e stafit akademik, drejtuesit e departamenteve ose këshilltarët akademikë rreth shqetësimeve specifike në lidhje me drejtësinë e vlerësimit. Gjithashtu, AU posedon një proces të strukturuar apelimi që u lejon studentëve të kontestojnë zyrtarisht notat e tyre. Studentët inkurajohen që fillimisht të diskutojnë shqetësimet e tyre me pedagogun përkatës për të sqaruar vendimet e notimit ose për të adresuar ndonjë keqkuptim. Nëse nuk zgjidhet, studentët mund të paraqesin një ankesë zyrtare në Sekretarinë Mësimore brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve, duke përmendur arsye specifike për kontestimin e notës. Fakulteti përkatës shqyrton ankesën përmes një komisioni ad hoc të ngritur. Kjo siguron që puna e studentit të rishikohet në mënyrë objektive. Pas komenteve dhe apeliemeve, departamentet inkurajohen të rishikojnë dhe reflektojnë mbi praktikat e vlerësimit për të identifikuar çdo

	çështje ose mospërputhje të përsëritur. Kjo mund të çojë në rregullime në kriteret e notave, përmirësim të trajnimit për stafin akademik ose përditësime të politikave të vlerësimit për të rritur drejtësinë. Institucioni informon studentët për rezultatet e apelimeve nëpërmjet Sekretarisë Mësimore brenda një jave nga dita e depozitimit të ankesës. Vendimi i bashkëlidhet proces-verbalit të fletës të provimit (Ref. RVB, fq. 48; Evidencë H.3. - Ngritja e grupeve për vlerësimin e brendshëm).			
Konkluzione	GVJ konfirmon se standardi është përmbushur plotësisht, siç dëshmohet nga argumentet e paraqitura në seksionin përshkruar. Studentët inkurajohen të ndajnë mendimet e tyre dhe të marrin pjesë në proceset vendimmarrëse në AU dhe brenda DSHJPA si dhe në FSHS. Ata ftohen të plotësojnë pyetësorët si pjesë e procesit të vlerësimit të programit të studimit dhe të kenë mundësinë të apelojnë rezultatet akademike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	AU zbaton procedura të veçanta dhe formon njësi të dedikuara për të ofruar informacion dhe shërbime për studentët, në përputhje me rregulloret ligjore dhe institucionale. Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët është përgjegjëse për koordinimin e shërbimeve të studentëve, duke përfshirë regjistrimin, këshillimin akademik, dhe shërbimet mbështetëse. Ai shërben si një pikë kontakti parësore për studentët, duke siguruar që ata të marrin informacion dhe udhëzim thelbësor. Gjithashtu, Sekretaria Mësimore u ofron studentëve informacion mbi kërkesat për diplomë, përzgjedhjen e lëndëve, përparimin akademik dhe planifikimin e diplomimit. Këshilltarët i ndihmojnë studentët të lundrojnë në rrugëtimin e tyre akademik, duke iu përmbajtur politikave të vendosura nga institucioni për të mbështetur suksesin e studentëve. Zyra e Karrierës dhe Alumnit mbulon një sërë problematikash të tyre, nga orientimi, trajnimi deri tek këshillimi për punësim. GVJ vlerëson se AU ka një dokumentacion që detajon kërkesat ligjore për përcaktimin e procedurave e strukturave të

	posaçme për informimin, orientimin, këshillimin dhe mbështetjen e studentëve <i>(Ref. RVB, fq. 49; Evidencë 5.3. - Rregullore e Zyrës së Koordinimit dhe Mbeshtetjes ndaj Studentëve; Takimi me Sekretarinë Mësimore).</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	AU posedon zyra të specializuara për mbështetje dhe këshillim për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Këto zyra ofrojnë shërbime duke siguruar mbështetje gjithëpërfshirëse për qëllimet akademike dhe profesionale të studentëve. Nga takimi i GVJ me keta zyra konkludohet se AU ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin e studentëve lidhur me çështje të procesit mësimor e programet e studimit MShAP. DSHJPA orienton politikat e tutorialit për mbarëvajtjen e procesit mësimor, kurse Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët si dhe Sekretaria Mësimore ofrojnë shërbime këshillimore dhe orientuese në dobi të karrierës së studentëve, kurse Këshilli Studentor, i cili mundëson përcjelljen e informacioneve të studentëve në strukturat vendimarrëse të AU dhe anasjelltas <i>(Ref. RVB, fq. 49; Evidencë 5.3. - Rregullore e Zyrës së Koordinimit dhe Mbeshtetjes ndaj Studentëve; Takimi me Sekretarinë Mësimore).</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	AU ofron një shërbim të dedikuar këshillimi për karrierë për të mbështetur kalimin e studentëve nga studimet akademike në karriera profesionale. Zyra e Karrierës dhe Alumnit, ofron udhëzime të vazhdueshme dhe periodike të përshtatura për nevojat e zhvillimit të karrierës së studentëve. Zyra e karrierës organizon punëtori dhe seminare të rregullta mbi tema të tilla si teknikat e kërkimit të punës, aftësitë e rrjetëzimit, dhe komunikimi profesional. Studentët marrin udhëzime për zgjedhjen e mundësive që lidhen me fushën e tyre të studimit, duke fituar përvojë praktike që rrit punësueshmërinë. Zyra e këshillimit të karrierës bashkëpunon me institucione dhe kompani të tjera për të lehtësuar praktikant dhe vendosjen e praktikës profesionale. AU organizon panairë pune në kampus, duke lidhur studentët me punëdhënësit e mundshëm dhe profesionistët e industrisë. Këto ngjarje i lejojnë studentët të mësojnë rreth hapjeve të punës, të takojnë rekrutuesit dhe të ndërtojnë rrjetet e tyre profesionale. Zyra e Karrierës dhe Alumnit orienton studentët gjatë gjithë ciklit të studimit për mundësitë e praktikave mësimore dhe mundësitë e punësimit përmes kontakteve individuale ose trajnimeve në grup. Zyra vepron edhe duke aktivizuar rrjetet alumni të të diplomuarve për tu sjellë

	studentëve modele positive. Nëpërmjet ofrimit të mundësive për praktikat profesionale duke përdorur marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara nga ana e institucionit, studentëve ju jepet mundësi punësimi bazuar në aftësitë që ata demonstrojnë (Ref. RVB, fq. 49; Evidencë 1.8. - Aktivitete Ekstrakurrikulare; RVB Aneks - Tabelat Përmbledhëse - Tabela 5; Evidencë 5.2. - Rregullore e Zyrës së Karrierës dhe Alumnit; Evidencë 5.4. - Panairi Work & Study; Takimi me Zyrën e Karrierës dhe Alumnit).			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Nga biseda e GVJ me Zyrën e Karrierës dhe Alumnit, konfirmojmë se specialistja e saj mban kontakte të vazhdueshme me studentët edhe pas diplomimit, duke aktivizuar rrjetin alumni. Rrjeti Alumni krijon mundësi shpërndarje informacioni për mundësi praktikash dhe punësimi për studentët. Në partneritet me rrjetin e të diplomuarve, zyra e karrierës lidh studentët aktualë me ata të diplomuar të cilët mund të ofrojnë udhëzime mbi opsionet e karrierës, njohuritë e industrisë dhe procesin e aplikimit për punë (Ref. RVB, fq. 49-50; Evidencë 5.13. - Statistika të punësimit të studentëve; Takimi me Zyrën e Karrierës dhe Alumnit).			
Konkluzione	GVJ vlerëson se AU ka formuar dokumentacion gjithëpërfshirës që përshkruan procedurat dhe njësitë speciale të dedikuara për pritjen, orientimin dhe këshillimin e studentëve. DSHJPA koordinon në mënyrë efektive aktivitetet e tij me të gjitha strukturat përkatëse të AU, duke siguruar që shërbimet të jenë vazhdimisht të disponueshme dhe lehtësisht të arritshme për studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Udhëzimet e AU pasqyrojnë një gamë të gjerë nevojash pedagogjike dhe mbështesin metoda inovative dhe gjithëpërfshirëse të mësimdhënies. Stafi akademik është angazhuar për të kuptuar sfidat e mësimdhënies, fushat e mundshme për inovacion dhe metodat e preferuara të mësimdhënies. Shembuj të brendshëm dhe të jashtëm të praktikave të suksesshme të mësimdhënies që lidhen me secilën fushë akademike analizohen dhe aplikohen nga stafi akademik. Udhëzimet e AU promovojnë fleksibilitet për të përshtatur metoda të ndryshme të mësimdhënies, të tilla si leksione, seminare, dhe të mësuarit e bazuar në projekte dhe mjete dixhitale të përshtatshme që përputhen me nevojat specifike të disiplinës përdoren. GVJ vlerëson që AU ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies, ka krijuar strukturat përgjegjëse si Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe aktet rregullative mbi bazën e të cilave garanton zhvillimin e metodave interaktive të mësimdhënies. Formatet e syllabuseve mundësojnë që stafet akademike të përcaktojnë një larmi metodash mësimdhënie, në varësi të fushave që mbulojnë <i>(Ref. RVB, fq. 50; Evidencë 6.1. - Klasa Teams; Evidencë 6.4. - Krijimi i zyrës së sigurimit të brendshëm të cilësisë – 23.07.2010; Evidencë 6.6.a. Vendimi për grupet e sigurimit të cilësisë në nivel Departamenti – 08.09.2016; Evidencë 6.6.b. - Grupet e Sigurimit të Cilësisë; Evidencë 6.7. - Strategjia për Sigurimin e Cilësisë 2022 – 2025; Evidencë 6.8.c. Rregullore për mbarëvajtjen e kurrikulave dhe procesit mësimor në AU; Takimi me NJSBC).</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	AU mbledh rregullisht komente nga studentët mbi efektivitetin e mësimdhënies, përshtatshmërinë dhe inovacionin në mësimdhënie. Vlerësimet nga studentët përdoren për të kapur përvojat dhe sugjerimet e studentëve. NJSBC përdor një pyetësor në fund të çdo semestri që plotësohet vullnetarisht nga studentët për çdo lëndë në funksion të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së programit të studimit. NJSBC dhe DSHJPA vlerësojnë periodikisht aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik mbi bazën e treguesve të aktivitetit të tyre shkencor dhe përmes raporteve semestrale të vetë pedagogëve. Gjathashtu, Zyra e Zhvillimit të Kurrikullave dhe Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin në bashkëpunim me Departamentet monitorojnë plotësimin e standardeve të cilësisë në mësimdhënie nga stafi akademik përmes

	takimeve për përmirësimin e kurrikulave apo planprogrameve. Megjithatë, nuk ka mekanizma dhe praktika të tjera specifike për kontrollin e cilësisë së mësimdhënies, p.sh. vëzhgimi në klasë, ku NJSBC ose udhëheqësit ose kolegët vlerësojnë praktikën e mësimdhënies së njëri-tjetrit. Bashkimi i stafit akademik me përvojë me ata që janë më të rinj në praktikën e mësimdhënies ofron mundësi të mësuarit nga kolegët <i>(Ref. RVB, fq. 50; Evidencë 3.2.a. - Rezultatet e pyetësorit drejtuar studentëve për mësimin online v.a. 2019 – 2020; Evidencë 3.2.b. - Rezultatet e Fokus grupeve; Evidencë 3.3. - Shembull pyetësorit në platformën Teams; Evidencë 6.3. - Model Raporti Semestral Pedagog; Takimi me NJSBC).</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	GVJ vlerëson se institucioni mundëson përfshirjen e studentëve përmes pyetësorëve ku kërkohet një vlerësim studentëve për procesin e mësimdhënies në fund të çdo semestri dhe gjatë vitit të fundit akademik. Megjithatë, vlerësimi i bërë nga studentët nuk është i detyrueshëm <i>(Ref. RVB, fq. 50-51; Evidencë 3.2.a. - Rezultatet e pyetësorit drejtuar studentëve për mësimin online v.a. 2019 – 2020; Evidencë 3.2.b. - Rezultatet e Fokus grupeve; Evidencë 3.3. - Shembull pyetësorit në platformën Teams; Takimi me NJSBC dhe me studentët).</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Përgjegjësi i DSHIPA komunikon në mbledhje rezultatet e përgjithshme dhe pastaj çdo pedagogu në veçanti ato specifike. Mbi bazën e analizës së rezultateve të anketimit, Senati Akademik nxjerr problematikat dhe reagon për përmirësimin e tyre. Rezultatet përfshihen në raportin vjetor institucional (Ref. RVB, fq. 51; Takimi me NJSBC).
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Gjetjet e vlerësimit ndahen me stafin në mënyrë konstruktive, duke ofruar reagime vepruese dhe duke përshkruar pritshmëritë. Të dhënat e grumbulluara të vlerësimit analizohen për të identifikuar tendencat ose nevojat e përbashkëta <i>(Ref. RVB, fq. 51; Takimi me NJSBC).</i>
Konkluzione	<i>Ky vlerësim nxjerr në pah një vlerësim pozitiv nga GVJ, duke treguar se AU ka krijuar një bazë për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie. Politika e AU siguron një qasje sistematike ndaj</i>

	cilësisë së mësimdhënies. NJSBC ka të ngjarë të shërbejë si një organ kyç që mbikëqyr cilësinë e mësimdhënies. Nëpërmjet vlerësimeve të vazhdueshme dhe mekanizmave të feedback-ut, AU angazhohet për përmirësimin e vazhdueshëm të procesit të mësimdhënies. Megjithatë, vlerësimet nga studentët në fund të çdo semestri do të duhet të bëhen të detyrueshme në mënyrë që të rritet përfshirja e studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
